



UDHËZUES PËR VLERËSIMIN E NXËNËSVE GJATË MËSIMIT NË DISTANCË DHE PËR MBYLLJEN E VITIT SHKOLLOR 2019-2020

(Në ndihmë të drejtuesve, mësuesve, prindërve dhe nxënësve
të institucioneve arsimore parauniversitare)





UDHËZUES PËR VLERËSIMIN E NXËNËSVE GJATË MËSIMIT NË DISTANCË DHE PËR MBYLLJEN E VITIT SHKOLLOR 2019-2020

(Në ndihmë të drejtuesve, mësuesve, prindërve dhe nxënësve
të institucioneve arsimore parauniversitare)



Maj 2020

Udhëzues për vlerësimin e nxënësve gjatë mësimit në distancë
dhe për mbylljen e vitit shkollor 2019-2020

Maj 2020
Tiranë

© Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR)
© Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar

TABELA E PËRMBAJTJES

► 1. HYRJJE	7
► 2. PARIMET E VLERËSIMIT TË MËSIMIT NË DISTANCË	9
2.1 Mirëqenia e nxënësve	9
2.2 Vlefshmëria dhe besueshmëria	9
2.3 Transparenca	10
2.4 Etika	10
2.5 Gjithëpërfshirja e nxënësve	10
► 3. METODAT E VLERËSIMIT TË NXËNËSVE GJATË MËSIMIT NË DISTANCË	11
3.1 Metoda dhe rekomandime të përgjithshme për vlerësimin gjatë mësimit në distancë	11
3.2 Rekomandime, detyra dhe aktivitete gjatë mësimit në distancë	11
3.3 Vëzhgimi dhe vlerësimi me gojë gjatë mësimit në distancë	12
3.4 Vlerësimi i diskutimeve të situatave konkrete nga jeta reale	13
3.5 Vlerësimi nëpërmjet procesit të vendimmarrjes	13
3.6 Paraqitja e detyrave dhe e punimeve gjatë mësimit në distancë	13
3.7 Vlerësimi nëpërmjet një projekti dhe detyre krijuese gjatë mësimit në distancë	14
3.8 Vlerësimi nëpërmjet hulumtimit gjatë mësimit në distancë	14
3.9 Vlerësimi me shkrim gjatë mësimit në distancë	14
3.10 Vetëvlerësimi dhe vlerësimi ndërmjet nxënësve gjatë mësimit në distancë	15
3.11 Vlerësimi i angazhimit dhe i pjesëmarrjes gjatë mësimit në distancë	16
3.12 Përfshirja e prindërve gjatë mësimit në distancë	16
3.13 Kriteret e vlerësimit gjatë mësimit në distancë	16
3.14 Reflektimi i mësuesit gjatë mësimit në distancë	17
► 4. FORMAT E VLERËSIMIT TË NXËNËSVE GJATË MËSIMIT NË DISTANCË	18
4.1 Vlerësimi i vazhduar për të nxënë (vlerësim formues)	18
4.2 Vlerësimi i portofolit	19
4.3 Vlerësimi me test/detyrë përmbledhëse	20
► 5. ROLET DHE PËRGJEGJËSITË NË VLERËSIMIN NË DISTANCË	22
5.1 Roli i mësuesit për vlerësimin gjatë mësimit në distancë	22
5.2 Roli i nxënësit për vlerësimin gjatë mësimit në distancë	23
5.3 Roli i prindërve për vlerësimin gjatë mësimit në distancë	23
5.4 Raportimi për ecurinë e nxënësve gjatë procesit të mësimit në distancë	24
5.5 Reagimi i shkollave lidhur me mësimin në distancë	25

► 6. MBYLLJA E VITIT SHKOLLOR 2019-2020	26
6.1 Vijueshmëria dhe realizimi i programit mësimor në përfundim të vitit shkollor, për klasat 1-11	26
6.2 Vijueshmëria dhe realizimi i programit mësimor në përfundim të vitit shkollor, klasa 12	27
6.3 Organizimi i mësimit për klasën e 12-të gjatë kthimit në mjediset e shkollës	27
6.4 Procedurat e vlerësimit të nxënësve në klasat 1-12	28
6.4.1 Procedurat e vlerësimit të periudhës së tretë (prill – maj)	28
6.4.2 Shënimi i vlerësimeve në regjistër	29
6.4.3 Procedurat e vlerësimit përfundimtar	29
6.4.3.1 Nxënësit në klasat 1-3	29
6.4.3.2 Nxënësit në klasat 4 – 12	30
6.5 Vlerësimi i angazhimit të nxënësit gjatë gjithë procesit të mësimit në distancë	32
► 7. VLERËSIMI ME NOTË I NXËNËSVE QË NUK DO T’U NËNSHTROHEN PROVIMEVE KOMBËTARE TË ARSIMIT BAZË PËR VITIN SHKOLLOR 2019-2020	33
7.1 Procedura e llogaritjes së notës së provimeve kombëtare të arsimit bazë	33
► 8. SHTOJCA 1 (PËR TESTET/DETYRAT PËRMBLEDHËSE)	34

LISTA E SHKURTESAVE

MASR	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
ASCAP	Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar
DPAP	Drejtorja e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar
DRAP	Drejtorja Rajonale e Arsimit Parauniversitar
ZVA	Zyra Vendore Arsimore
RTSH	Radio Televizioni Shqiptar
KV	Komisioni i Vlerësimit
NK	Nuk u krye
NVv	Nota e vlerësimit të vazhduar
NTp	Nota e testit/detyrës përmbledhëse
NVp	Nota e vlerësimit të portofolit
NPK	Nota e provimit kombëtar
NP	Nota përfundimtare
PEI	Plani Edukativ Individual

1. HYRJE

Pandemia COVID-19 konsiderohet një sfidë e madhe globale, e cila ka ndikuar në çdo aspekt dhe sektor të shoqërisë, përfshirë edhe arsimin. Shumica e vendeve në Evropë dhe më gjerë i kanë mbyllur institucionet arsimore, si pjesë e masave të tyre për të kufizuar kontaktin mes njerëzve dhe për të parandaluar përhapjen e virusit. Edhe në vendin tonë, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR) ka mbyllur institucionet arsimore që nga data 9 mars 2020 dhe ka vendosur që nxënësit e klasave 1-11 do të vijojnë mësimin në distancë deri në datë 29 maj 2020. Nxënësit maturantë do të kthehen në shkollë në datë 18 maj dhe do të vijojnë mësimin në shkollë deri në datë 5 qershor. Provimet e Maturës Shtetërore do të zhvillohen gjatë periudhës 8-18 qershor, ndërkohë që provimet kombëtare të arsimit bazë për klasën e pestë dhe për klasën e nëntë nuk do të zhvillohen.

Nxënësit e klasave 1 -11 do të vijojnë mësimin në distancë deri në datën **29 maj 2020**, duke u bazuar në planin mësimor dhe në orarin mësimor të hartuar nga secila shkollë për lëndët dhe klasat përkatëse.

Maturantët do të vijojnë mësimin në distancë deri në datën **15 maj 2020**. Maturantët do të mbyllin lëndët që nuk kanë provime të Maturës Shtetërore deri në **30 prill 2020**.

Maturantët nga data **4 maj - 15 maj 2020**, gjatë mësimin në distancë do të zhvillojnë **vetëm lëndët që kanë provim në Maturën Shtetërore**. Shkollat do të përshtasin orarin.

Maturantët **kthehen në mjediset e shkollës** në datën **18 maj - 5 qershor 2020**. Gjatë kësaj periudhe shkollat përshtasin orarin për të zhvilluar vetëm lëndët e provimeve të Maturës Shtetërore. Mësimi do të zhvillohet sipas parimit të distancimit social.

Provimet kombëtare për klasën e 5-të dhe për klasën e 9-të **nuk do të zhvillohen. Provimet e Maturës Shtetërore do të zhvillohen në periudhën 8-18 qershor 2020**.

Nota e nxënësve për provimet kombëtare të klasës së 9-të do të llogaritet si **mesatare aritmetike e notave përfundimtare të nxënësve për katër klasat** e arsimit të mesëm të ulët (klasat 6, 7, 8, 9)

Dy format kryesore mësimore të mësimin në distancë që po përdoren në vendin tonë janë:

- *Mësime të xhiruara dhe të transmetuara në Radio Televizionin Shqiptar (RTSH). Këto mësime ndiqen nga 78.9% e nxënësve, 79.9% e prindërve dhe 96.4% e mësuesve¹. Nxënësit që nuk arrijnë të shohin transmetimet, i ndjekin videot te kanali Youtube i MASR-së apo edhe te platforma akademi.al.*
- *Komunikimi mes nxënësve dhe mësuesve përmes rrjeteve sociale apo përmes platformave të ndryshme që mundësojnë krijimin e klasave virtuale (google classroom, google hangout, edmodo, zoom etj.). Një numër shumë i konsiderueshëm i nxënësve, prindërve dhe mësuesve janë angazhuar në mësimet online: 96.8% e nxënësve, 95.3% e prindërve dhe 98.7% e mësuesve².*

Gjithashtu, MASR ka bashkëpunuar me institucionet e saj të varësisë, organizatat, bizneset, shtëpitë botuese etj., me qëllim hartimin e udhëzuesve në ndihmë të mësuesve, nxënësve dhe

¹ Të dhënat janë marrë nga sondazhi i zhvilluar nga ASCAP në datat 4-7 prill 2020.


² Të dhënat janë marrë nga sondazhi i zhvilluar nga ASCAP në datat 4-7 prill 2020

prindërve; evidentimin dhe zgjidhjen e problematikave të mësimi në kushtet e shtëpisë; ofrimin e shërbimit psikologjik për nxënësit; trajnimin e mësuesve për përdorimin e platformave online; sigurimin e pajisjeve digjitale për fëmijët nga shtresat në nevojë etj.

Mësimi në distancë fillon me një planifikim të kujdesshëm, zbaton kërkesat e kurrikulës, **përqendrohet në mirëqenien psiko-emocionale të nxënësve dhe përdor teknologjinë si mjet** për realizimin e procesit të të nxënës. Ky lloj mësimi është risi dhe një sfidë e re për mësuesit.

Udhëzuesi për vlerësimin e nxënësve gjatë mësimi në distancë dhe për mbylljen e vitit shkollor 2019-2020” ka për qëllim të ofrojë udhëzime për mësuesit, nxënësit dhe prindërit në lidhje me:	
1	metodat dhe format e vlerësimit të nxënësve;
2	rolin e mësuesve, nxënësve dhe prindërve në vlerësimin e nxënësve;
3	procedurat e vlerësimit përfundimtar të nxënësve në fund të vitit shkollor 2019-2020, për klasat 1-12;
4	procedurat e plotësimit të dokumentacionit shkollor;
5	organizimin e mësimi për maturantët në kushtet e kthimit në shkollë;
6	kushtet e mjediseve shkollore sipas parimit të distancimit social dhe higjienizimi i tyre;
7	vlerësimet me notë në provimet kombëtare të arsimit bazë.

Duke marrë në konsideratë kompleksitetin e situatës që po kalojmë, të papriturat që sjell mësimi në distancë dhe faktin që çdo shkollë dhe nxënës ka specifikat dhe nevojat e veta, udhëzuesi jep disa skenarë dhe ide se si shkollat dhe mësuesit mund të vlerësojnë nxënësit duke iu përshtatur rrethanave, mundësive dhe specifikave të tyre. Në kushtet e zhvillimit të mësimi në distancë, **në rastet kur nxënësit nuk kanë mundur të angazhohen në mësimin online** për shkak të mungesës së teknologjisë, **vlerësimi i tyre do të bazohet në notat dhe shënimet që ka mbajtur mësuesi deri në periudhën e qëndrimit në shtëpi.**



2. PARIMET E VLERËSIMIT TË MËSIMIT NË DISTANCË

Jeta e nxënësve gjatë pandemisë COVID-19 është krejtësisht e ndryshme nga ajo e dy muajve më parë, ndaj edhe ajo që ata mund të arrijnë nuk mund të jetë në të njëjtat standarde si më parë. Nisur nga kjo, mësuesit duhet të përcaktojnë rezultate të nxëni që mund të arrihen në këtë situatë, të zhvillojnë një proces mësimor të këndshëm dhe motivues, gjatë të cilit nxënësve duhet t'u krijojnë mundësinë t'i përmbushin këto rezultate, si dhe të vlerësojnë arritjet e nxënësve. Krahas arritjes së rezultateve të të nxënit, gjatë vlerësimit **mësuesit duhet të jenë empatikë dhe të kujdesen për mirëqenien e nxënësve.**

Në kushtet e zhvillimit të mësimin në distancë, vlerësimi i nxënësve do të mbështetet në këto parime:

Mirëqenia e nxënësve
Vlefshmëria dhe besueshmëria
Transparenca
Etika
Gjithëpërfshirja e nxënësve

2.1 Mirëqenia e nxënësve

Pandemia COVID-19 ka sjellë frikë, ankth dhe pasiguri te të gjithë. Fëmijët janë ata që i vuajnë më shumë këto pasoja. **Në këto kushte qëllimi kryesor i vlerësimit duhet të jetë mirëqenia e nxënësve dhe jo vlerësimi i njohurive të tyre.** Komentet dhe sugjerimet e mësuesve gjatë vlerësimit duhet të përqendrohen në nxitjen dhe në mbështetjen e fëmijëve për të nxënë. Nëse mësuesit janë mbështetës, të durueshëm, inkurajues, pozitivë dhe të vëmendshëm ndaj nxënësve, atëherë do të shmangen efektet negative psikologjike që mund të shkaktojë pandemia tek ata.

2.2 Vlefshmëria dhe besueshmëria

Mësimdhënia bashkëkohore përqendrohet jo në përvetësimin e njohurive, por në pajisjen e nxënësve me kompetencat e nevojshme për të jetuar dhe punuar në shekullin XXI. Ky ndryshim duhet reflektuar edhe në procesin e vlerësimit. **Vlerësimi me në qendër nxënësin mund të bëhet edhe në një klasë virtuale.**

Në këtë situatë, mësuesit duhet të përdorin një larmi instrumentesh vlerësimi, të gjykojnë me kujdes për arritjet e nxënësve, të marrin në konsideratë angazhimin dhe gatishmërinë e nxënësve në mësimin online, si dhe mirëqenien e tyre. Kështu ata mund të arrijnë të realizojnë një vlerësim të besueshëm dhe të vlefshëm bazuar në reflektime dhe sugjerime motivuese për nxënësit.

Gjatë mësimin në distancë, dy llojet e vlerësimit që rekomandohen më së shumti janë vlerësimi i vazhduar dhe vlerësimi i portofolit elektronik.

2.3 Transparenca

Nxënësit kanë të drejtë dhe nevojë të njihen me kriteret me të cilat do të vlerësohen. Kjo garanton paanshmërinë dhe transparencën e vlerësimit dhe ndihmon të nxënësit. ***Kriteret e qarta dhe të hapura ndihmojnë gjykimet profesionale, sigurojnë që vendimet të shqyrtohen nga të gjithë dhe të jenë të qëndrueshme.*** Vlerësimi gjatë mësimit në distancë duhet të jetë transparent jo vetëm për nxënësit, por edhe për prindërit. Transparenca nuk ka për qëllim vetëm informimin e prindërve, por edhe bashkëpunimin dhe përfshirjen e tyre në mësimin e fëmijëve.

2.4 Etika

Vlerësimi i informacionit teorik ose i përmbajtjes mësimore lëndore do të krijonte mundësi që nxënësit të kopjonin. ***Kopjimi dhe cenimi i të drejtës së autorit nuk janë etike.*** Për ta shmangur këtë mësuesit duhet të përqendrohen në detyra që lidhen me përpunimin e informacionit nga nxënësit duke zhvilluar mendimin kritik nëpërmjet analizës, vlerësimit, gjykit, sintezës, krijimit, zgjidhjes problemore, identifikimit të shkakut dhe të pasojës, dallimit të fakteve dhe të opinionëve etj. Gjithashtu, gjatë mësimit në distancë duhen shmangur rreptësisht përmbajtje, mesazhe dhe simbole që nuk përkojnë me misionin dhe detyrën e mësuesit, si dhe me normat etike të shoqërisë.

2.5 Gjithëpërfshirja e nxënësve

Gjatë mësimit në distancë, mësuesi duhet të jetë gjithëpërfshirës, fleksibël dhe të përdorë forma të përshtatshme vlerësimi për nxënësit me aftësi të kufizuara, për fëmijët romë dhe egjiptianë, për fëmijët që jetojnë në kushte të vështira ekonomike, për fëmijët që kanë mungesë të qasjes në teknologjinë e nevojshme për të mësuar në distancë (p.sh., internet të shpejtë ose kompjuter në shtëpi).

3. METODAT E VLERËSIMIT TË NXËNËSVE GJATË MËSIMIT NË DISTANCË

Mësimi në distancë, me gjithë vështirësitë, ka krijuar mundësi që mësuesit të përdorin më shumë burime digjitale alternative për të zhvilluar njohuritë dhe aftësitë e kërkuara nga kurrikula me kompetenca, si dhe për të realizuar vlerësimin e nxënësve.

3.1 Metoda dhe rekomandime të përgjithshme për vlerësimin gjatë mësimit në distancë

Vlerësimi është pjesë integrale e procesit të mësimdhënies dhe të nxënësve dhe duhet planifikuar si i tillë. Me anë të metodave dhe të teknikave të ndryshme të vlerësimit, mësuesi mbledh informacione për arritjen e rezultateve të pritshme të nxënësve në nivel klase. Metodave dhe teknikave të vlerësimit që mësuesi zbaton përgjatë vlerësimit të vazhduar, vlerësimit me test dhe vlerësimit të portofolit lëndor, janë përcaktuar qartazi në një sërë dokumentesh themelore kurrikulare të hartuara gjatë viteve të fundit, në kuadër të zbatimit të kurrikulës së re të arsimit parauniversitar. Ato i gjejmë në “Kornizën e vlerësimit të nxënësve në arsimin parauniversitar³”, në materialin shpjegues në ndihmë të shkollave “Vlerësimi i nxënësve në arsimin e mesëm të ulët dhe në arsimin e mesëm të lartë⁴”, si dhe më të detajuara e më të specifikuar për secilën lëndë, këto metoda gjenden sipas klasave, në rubrikën e vlerësimit në programet lëndore dhe në “Udhëzuesit kurrikularë lëndorë⁵”, ku jepen shembuj praktikë të zbatimit të tyre në orën e mësimit.

Disa metoda dhe teknika që mund të përdoren gjatë mësimit online, janë:

- Vlerësimi me gojë (të pyeturit, diskutimi, intervista, debati, prezantimi etj.).
- Vlerësimi përmes punimeve të ushtrimeve/kërkesave (kontrolli dhe reflektimi për detyrat e realizuara).
- Vlerësimi përmes detyrave hulumtuese dhe krijuese.
- Vlerësimi përmes punëve praktike.
- Vlerësimi përmes projekteve.
- Vlerësimi me shkrim (test, kuize, ese, detyra të veçanta për grupe nxënësish, detyra në grup ose individuale).
- Vlerësimi përmes diskutimeve të situatave konkrete nga jeta reale.
- Vetëvlerësimi.
- Vlerësimi i nxënësve nga nxënësi.

3.2 Rekomandime, detyra dhe aktivitete gjatë mësimit në distancë

Gjatë mësimit në distancë mësuesi është i lirë të përzgjedhë dhe të zhvillojë sipas përvojës dhe mundësive secilën nga metodat e mësipërme. Metodave dhe teknikave të përzgjedhura duhet t’u krijojnë mundësi të gjithë nxënësve të vlerësohen në atë mënyrë që është më e përshtatshme për to.

Vlerësimi si proces që drejton të nxënësve, udhëhiqet nga rezultatet e të nxënësve të përcaktuara në programet lëndore. Mësuesi nuk ka të drejtë të vlerësojë nxënësin për njohuri dhe aftësi që nuk përfshihen apo nuk përshkruhen në këto programe. Gjatë mësimit në distancë mësuesi duhet

³ <https://www.ascap.edu.al/wp-content/uploads/2020/02/Korniza-e-vleresimit-te-nxenesit-23-korrik-2015.pdf>

⁴ <https://www.ascap.edu.al/wp-content/uploads/2018/11/Materiali-shpjegues-per-vleresimin-e-nxenesit-1.pdf>

⁵ <https://www.ascap.edu.al/udhezues-lendore/>

të planifikojë, të zhvillojë dhe të vlerësojë vetëm ato aftësi, të cilat ai i përcakton si më të rëndësishme dhe më të realizueshme në kushtet e mësimi në shtëpi.

Vlerësimi i nxënësve duhet të nxjerrë në pah arritjet e tyre, në mënyrë që ata të inkurajohen të mësojnë me më shumë dëshirë. Ai duhet të konsiderohet si një mjet në ndihmë të nxënësve, që ata të njohin më mirë aftësitë e tyre në të nxënë, të zhvillojnë e të përdorin talentet dhe aftësitë në mënyrë sa më të dobishme. Mësuesi gjatë mësimi në distancë duhet të planifikojë diskutime, detyra dhe aktivitete efektive në mënyrë që nxënësit të dëshmojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre dhe të demonstrojnë të nxënëit e tyre.

Mësuesi duhet të sigurohet që vlerësimi është i përshtatshëm me rezultatet e synuara, duke konsideruar me kujdes faktorët kryesorë të vlerësimit. Ai duhet të ngrejë pyetje e mëposhtme dhe të diskutojë rreth tyre:

Pyetjet:

- Si do të diskutojmë dhe biem dakord mbi rezultatet e pritshme që synohen për nxënësit?
- Si do të përshtasim eksperiencën me arritjet ose formimin e nxënësve?
- Çfarë burimesh të evidencave do të përdorim?
- Si do të veprohet me vështirësitë ndaj të nxënëit dhe arritjeve?
- A janë të qarta udhëzimet që iu jepen nxënësve mbi atë që ata duhet të bëjnë?
- Çfarë duhet të thonë, shkruajnë, bëjnë ose krijojnë nxënësit për të përmbushur rezultatet e të nxënëit?

Mësuesi duhet të bashkëpunojë me nxënësit për përcaktimin e qasjes më të përshtatshme të vlerësimit. Ai duhet të përdorë mënyra vlerësimi që shmangin ndonjë pengesë të panevojshme, si dhe të zgjedhë të dhënat e përshtatshme që masin arritjet dhe përmbajnë atë që nxënësit duhet të dinë, të shkruajnë, të bëjnë dhe të prodhojnë për të treguar sukses.

Si burime të evidencave mund të shërbejnë:

- vëzhgime dhe vlerësimi me gojë të nxënësve për detyra dhe aktivitete, si p.sh., kontrolli dhe reflektimi për detyrat e realizuara, diskutime, prezantime etj.;
- produkte, si p.sh.: një detyrë krijuese, projekt, raport etj.;
- vlerësime me shkrim (test, kuize, ese, veprimtari praktike, detyra të veçanta sipas specifikave të nxënësve);
- dokumente, materiale, të dhëna (me gojë, shkrim, audio – vizuale) të krijuara nga nxënësit, të cilat mund të përfshijnë vetëvlerësim dhe/ose vlerësim ndërmjet nxënësve ose mund të vlerësohen nga mësuesit.

3.3 Vëzhgimi dhe vlerësimi me gojë gjatë mësimi në distancë

Mësuesi gjatë vëzhgimit dhe vlerësimit me gojë në kushtet e mësimi në distancë, të realizuar në komunikim të drejtpërdrejtë në rrjete sociale,

- Mund të pyesë dhe të vlerësojë nxënësit brenda 3-5 minutave për realizimin e detyrave ose shpjegimin e koncepteve kryesore të njërës nga çështjet që ata kanë trajtuar gjatë mësimi online.
- E rëndësishme gjatë vëzhgimit dhe vlerësimit me gojë është reflektimi dhe vlerësimi i detyrave të shtëpisë të realizuara nga nxënësit të cilat mund të jenë detyra që gjenden në tekst, ushtrime apo detyra të veçanta për grupe nxënësish ose në mënyrë individuale.

- Mësuesi për këto detyra udhëzon paraprakisht për hapat që duhet të ndjekin nxënësit në kryerjen e detyrës, duke dhënë një shembull ose një zgjidhje.
- Mësuesi vëzhgon dhe vlerëson me kujdes punët e çdo nxënësi duke pyetur secilin prej tyre brenda një kohe të shkurtër se si e ka kryer apo zhvilluar një aspekt të detyrës.

Mbani mend: Mësuesit duhet të bëjnë kujdes të mos mbingarkojnë nxënësit me detyra dhe, aq më tepër, me detyra që nuk mund të kryhen në kushtet e shtëpisë.

Është e rëndësishme të balancohet ngarkesa e punës së nxënësve në mënyrë që ata të jenë në gjendje të paraqesin në kohë detyrën e tyre. Për këtë mësuesit duhet të koordinojnë punën me mësuesit e tjerë, ashtu siç bëjnë zakonisht kur nxënësit janë në shkollë.

3.4 Vlerësimi i diskutimeve të situatave konkrete nga jeta reale

Pjesë e vlerësimit me gojë është edhe diskutimi i një detyre apo i një veprimtarie nga një situatë e jetës reale. Nëse zhvillimi i diskutimit të detyrave apo të veprimtarive kërkon që nxënësit të gjejnë informacion në burime të tjera të nxëni, mësuesi i orienton nxënësit për këto burime, si p.sh., adresa web, libra etj., duke bërë kujdes që të konsultohet paraprakisht me nxënësit për mundësitë që ata kanë për t'i siguruar ato.

Diskutimi mbi tema të ndryshme është një metodë vlerësimi e cila ndihmon nxënësit të kuptojnë përmbajtjen, të zhvillojnë të menduarin dhe komunikimin, si dhe të zgjerojnë informacionet e tyre. Kjo metodë bën të mundur që mësuesi të vlerësojë nxënësit për mënyrën se si diskutojnë dhe ndërveprojnë me të tjerët, si dhe për nivelin e zbatimit të njohurive në jetën e përditshme. P.sh., mësuesi i biologjisë organizon një diskutim online me nxënësit për viruset. Gjatë diskutimit mësuesi vlerëson jo vetëm informacione të nxënësve për viruset, por edhe aftësitë e tyre për të respektuar rregullat e një diskutimi, për të pranuar mendimin ndryshe, për të moderuar një diskutim, për të argumentuar idetë e tyre etj.

3.5 Vlerësimi nëpërmjet procesit të vendimmarrjes

Vendimmarrja është procesi i zgjedhjes së një ose më shumë alternativave. Pjesë e procesit është analiza dhe vlerësimi i rezultateve të mundshme për të marrë vendime. Marrja e vendimeve është e rëndësishme, kur nxënësi zgjedh se cilat veprime ose formula mund të përdorë për të zgjidhur situatat problemore. Gjykimi përfshin opsionet e peshimit të vendimeve, të pasojave në marrjen e vendimeve dhe të provave për të ndërmarrë veprime në mënyrë efektive. P.sh., në lëndën e qytetarisë mësuesi kërkon nga nxënësit të vendosin se çfarë mund të bëjnë për të ndihmuar nxënësit më të vegjël të shkollës gjatë pandemisë. Gjatë diskutimit, mësuesi vlerëson nxënësit për aftësitë e tyre në paraqitjen e zgjidhjeve të mundshme, në gjykimin e zgjidhjes më të mirë dhe në marrjen e vendimit përfundimtar (ata mund të hartojnë një udhëzues të shkurtër, një model të regjimit ditor, disa sugjerime për lexime plotësuese, një ekspozitë online me punimet e tyre në faqen e internetit të shkollës etj.).

3.6 Paraqitja e detyrave dhe e punimeve gjatë mësimit në distancë

Prezantimi, shpjegimi dhe paraqitja e detyrave dhe e punimeve të ndryshme që nxënësit realizojnë, është për mësuesin tregues i aftësive të tyre për të mbledhur informacion, për ta përzgjedhur, për ta përpunuar dhe për ta paraqitur atë. Gjatë paraqitjes dhe prezantimit të punimeve, nxënësit vlerësohen edhe për shtjellimin e këndvështrimeve të tyre, mbrojtjen e

këtyre këndvështrimeve, mbajtjen e qëndrimit vetjak ose në grup ndaj një çështjeje të caktuar dhe respektimin e mendimit ndryshe. Me anë të kësaj teknike vlerësohen kompetencat lëndore dhe kompetencat kyç, si ajo e komunikimit dhe e të menduarit.

3.7 Vlerësimi nëpërmjet një projekti dhe detyre krijuese gjatë mësimit në distancë

Realizimi dhe zhvillimi i një projekti apo detyre krijuese i ndihmon nxënësit që të kërkojnë në burime të ndryshme informacioni, të lidhin njohuritë me jetën reale, të krijojnë, si dhe të prezantojnë punën e tyre online para mësuesit ose shokëve të tyre. Me anë të projektit/detyrës krijuese, mësuesi vlerëson aftësinë e nxënësve për të kërkuar informacion, për ta mbledhur, për ta përpunuar dhe për ta prezantuar atë. Realizimi i tij është tregues i përgjegjësisë vetjake, si dhe i përkushtimit dhe i interesit të secilit nxënës gjatë mësimit në distancë. Kjo metodë nxit bashkëpunimin ndërmjet nxënësve, edhe pse online në distancë, por më parë mësuesi duhet të sigurohet se sa i mundshëm është një bashkëpunim i tillë kur ata punojnë nga shtëpitë e tyre. Puna me projekte është një mundësi përmes të cilës mësuesi mund të vendosë një vlerësim përmbljedhës për nxënësit.

3.8 Vlerësimi nëpërmjet hulumtimit gjatë mësimit në distancë

Një nga mënyrat më të mira për të mësuar është që nxënësi të bëjë pyetje për çështje të cilat i interesojnë. Kjo do të thotë që nxënësi të bëjë kërkime për të gjetur përgjigjet e këtyre pyetjeve. Ka disa hapa që përdoren për kryerjen e hulumtimeve dhe rezultatet më të mira arrihen në qoftë se nxënësit i bëjnë gjërat në rendin e duhur dhe diskutojnë me mësuesit mbi pyetje si:

- Çfarë dua të zbuloj?
- Cili është qëllimi im?
- Ku mund të gjej informacionin për të cilin kam nevojë?
- Sa i rëndësishëm është informacioni që kam gjetur?
- Sa i besueshëm është informacioni që kam gjetur?
- A duhet ta përdor të gjithë informacionin?
- Si mund ta paraqes këtë informacion?
- Si ndikon te publiku prezantimi im?
- Çfarë mësova nga e gjithë kjo?
- A e kam arritur atë që synova?
- Etj.

3.9 Vlerësimi me shkrim gjatë mësimit në distancë

Vlerësimi me shkrim shërben si metodë për aftësimin e komunikimit me shkrim. Në përshtatje me qëllimin e vlerësimit me shkrim dhe specifikat e lëndës, mësuesi mund të përdorë teknika të vlerësimit me shkrim, si: test, kuiz, detyrë tematike, punë me shkrim, ese, veprimtari praktike apo projekt.

Gjatë mësimit në distancë sugjerohet të reduktohet shpeshtësia e përdorimit të testit si teknikë e vlerësimit me shkrim.

Për të inkurajuar nxënësit të mësojnë vazhdimisht, mësuesit i përgatisin ata për test duke përdorur ushtrime të thjeshta përmes të cilave nxënësit mund të mbledhin pikë të nevojshme për të marrë testin.

Mësuesi planifikon test me shkrim për atë grup rezultatesh mësimore të zhvilluara gjatë mëimit në distancë. Testimi i ndihmon mësuesit të vlerësojnë njohuritë e nxëna gjatë periudhës së mëimit në kushte shtëpie, për të nxitur nxënësit të punojnë me seriozitet, si dhe për të orientuar punën e mëtejshme në bazë të njohurive që nxënësit kanë nxënë gjatë punës në shtëpi.

Përpara testimit mësuesi iu prezanton nxënësve temat për të cilat do të kryhet testimi dhe zhvillon modele ushtrimesh që do të përfshihen në test. Mësuesi i sqaron nxënësit duke iu përgjigjur me kujdes çdo pyetjeje që nxënësit mund të kenë lidhur me testin/detyrën përmbledhëse apo paqartësi për ushtrime dhe çështje të caktuara.

Për hartimin e testit rekomandohet që mësuesi të bëjë kujdes si në formulimin e pyetjeve, ashtu dhe në përcaktimin e pikëve. Në test mund të përdoren pyetjet me alternativa, pyetjet me çiftim, pyetjet me plotësim, pyetjet e strukturuara, pyetjeve me përgjigje të shkurtër, por në varësi të lëndës mund të përdoren dhe pyetje me fund të hapur ose ese (*Në shtojcën 1 jepen shembuj testesh ose detyrash përmbledhëse për disa lëndë*). Nëse një platformë e re do të përdoret për zhvillimin e testit online në kohë reale, nxënësit duhet të jenë të familjarizuar me të më parë përmes mëimit, në mënyrë që të ulin ndikimin e mjedisit digjital në rezultatet e vlerësimit.

Në rastet, kur nxënësi nuk ka mundësi të marrë pjesë në aplikacionin online, mësuesi i kërkon nxënësve të fotografojnë zgjidhjet e pyetjeve/ushtrimeve në test dhe t'i dërgojnë ato në kohën e caktuar përmes aplikacionit që përdorin për komunikim si: email apo whatsapp. Kjo e dyta është e mundshme të realizohet edhe në rastet kur ka pengesa për shfrytëzim të pajisjeve dhe platformave të veçanta.

Kur dyshon në lidhje me rezultatet e testit, mësuesi mund të kontrollojë vërtetësinë e përgjigjeve duke folur me nxënësin. Nxënësit mund t'i kërkojë nga mësuesi të komentojë dhe të argumentojë zgjidhjet e paraqitura. Këtë mësuesi e realizon në orën e reflektimit në vijim.

Pas kryerjes së testit në orën në vijim, mësuesi realizon me nxënësit një orë diskutimi mbi punën e nxënësve në test për të sqaruar vështirësitë e hasura ose zgjidhjet e sakta të një pyetjeje/ushtrimi apo problemi. Kjo orë ka si qëllim reflektimin dhe dhënien e feedback-ut nga mësuesi në lidhje me rezultatet e testit.

3.10 Vetëvlerësimi dhe vlerësimi ndërmjet nxënësve gjatë mëimit në distancë

Kjo është një metodë e rëndësishme e vlerësimit, ku secili nxënës jep gjykimin për zotësinë e vet. Vetëvlerësimi është një element plotësues i domosdoshëm i vlerësimit nga mësuesi. Nxënësit vlerësojnë punën e tyre dhe të njëri-tjetrit. Më pas mësuesi dhe nxënësit bëjnë komentin përfundimtar. Mësuesi bisedon me nxënësin individualisht dhe i tregon arritjet. Interesi më i madh i vetëvlerësimit qëndron në faktin që ai është faktor motivimi dhe ndërgjegjësimi: ai i ndihmon nxënësit të njohin pikat e tyre të forta dhe të dobëta dhe kështu të organizojnë më mirë të nxëniet e tyre.

3.11 Vlerësimi i angazhimit dhe i pjesëmarrjes gjatë mësimit në distancë

Gjatë mësimit në distancë, pjesëmarrja dhe angazhimi marrin një peshë të rëndësishme në vlerësimin përfundimtar të nxënësve.

Në mësimin në distancë, pjesëmarrja, angazhimi dhe puna e pavarur e nxënësve duhet të vlerësohen, inkurajohen dhe shpërblehen nëpërmjet të gjitha metodave dhe teknikave: nga detyrat e shtëpisë, vlerësimet me gojë, vlerësimet me shkrim, deri te mësimi dhe kërkimi i pavarur. Qëllimi është të motivojmë nxënësit, t'i mbajmë të angazhuar si dhe t'i ndërgjegjësojmë ata për përgjegjësinë e tyre në mësimin dhe suksesin e tyre.

3.12 Përfshirja e prindërve gjatë mësimit në distancë

Në situatën aktuale të pandemisë, ku nxënësit kalojnë më shumë kohë me prindërit e tyre se zakonisht, mësuesit kanë një mundësi të përfshijnë prindërit në procesin e të nxënësve të fëmijëve. Për këtë **mësuesi duhet të vendosë kufij të qartë**, në mënyrë që prindërit ta dinë që mbështetja e mësimit të fëmijëve të tyre nuk nënkupton kryerjen e detyrës nga prindërit.

3.13 Kriteret e vlerësimit gjatë mësimit në distancë

Për të vlerësuar dhe për të klasifikuar detyrat, detyrat komplekse - hulumtime, detyrat krijuese, projektet etj., mësuesit duhet të përdorin rubrika apo kritere të përcaktuara vlerësimi, me qëllim vlerësimin e drejtë, të barabartë dhe transparent për të gjithë nxënësit. Kriteret e vlerësimit duhet t'u paraqiten nxënësve para se të fillojnë punën e tyre, dhe mësuesi duhet të sigurojë që këto të kuptohen mirë nga të gjithë.

Gjatë mësimit në distancë mësuesi mund të vlerësojë aspekte, të tilla si:

- pjesëmarrjen dhe interesin që shprehin nxënësit,
- pyetjet që shtrojnë nxënësit,
- përgjigjet dhe sugjerimet që nxënësit u japin pyetjeve të mësuesit dhe të nxënësve të tjerë,
- kryerjen në kohë, rregullisht dhe me saktësi të detyrave të shtëpisë,
- saktësinë e informacionit të paraqitur nga nxënësit,
- përkushtimin dhe këmbënguljen e nxënësve në kryerjen e detyrave të ndryshme,
- cilësinë e prezantimit të punimeve,
- aftësitë e nxënësve për të diskutuar, debatuar, krahasuar, argumentuar dhe parashikuar, duke mbajtur qëndrim vetjak ndaj një teme apo çështjeje të caktuar,
- ndërveprimet e nxënësve me njëri-tjetrin dhe me të rriturit,
- aftësinë e nxënësve për të punuar në mënyrë të pavarur,
- nivelin e ndërgjegjësimit të nxënësve për vështirësitë që mund të kenë të tjerët dhe gatishmërinë për t'i ndihmuar ata.

3.14 Reflektimi i mësuesit gjatë mësimit në distancë

Gjatë mësimit në distancë mësuesi vlerëson detyrën, duke marrë në konsideratë se reflektimet do ta ndihmojnë nxënësin të kuptojë pse ai mori atë rezultat dhe se si mund të përmirësohet herën tjetër.

Reflektimi duhet të jetë:

- konstruktiv, në mënyrë që nxënësi të ndihet i inkurajuar dhe i motivuar për t'u përmirësuar;
- në kohë, në mënyrë që nxënësi ta përdorë atë për të mësuar në vazhdim;
- i menjëhershëm, në mënyrë që nxënësi të mund të mbajë mend atë që bëri dhe të reflektojë në kohë;
- i fokusuar në arritje dhe përpjekje, jo te personi: puna dhe angazhimi duhet të vlerësohet, jo nxënësi;
- specifik për rezultatet e të nxënit, në mënyrë që vlerësimi të jetë i qartë lidhur me të mësuarin.

Përgjigjet e mësuesit mund të jenë:


- **informale** - të tilla si reagimet e drejtpërdrejta individuale me vetë nxënësin;
- **formale** - të tilla si listat e kontrollit ose komentet për nxënësin në mënyrë individuale në formë të shkruar ose në komunikim të drejtpërdrejtë;
- **formative** – të dhëna gjatë zhvillimit të mësimit online (nëse është e mundur), me qëllim ndihmën për nxënësin që të dijë se si të përmirësohet;
- **përmbledhëse** – të dhëna në fund të periudhës (ose të kapitullit), me qëllim informimin e nxënësve për çfarë kanë arritur.

Mësuesi gjatë vëzhgimit dhe vlerësimit mban shënim për secilin nxënë, në mënyrë që të krijojë një pamje të përgjithshme të ecurisë së zhvillimit të tyre. Kjo i shërben mësuesit për t'u komunikuar ecurinë nxënësve dhe prindërve të tyre, si dhe drejtorisë së shkollës.

4. FORMAT E VLERËSIMIT TË NXËNËSVE GJATË MËSIMIT NË DISTANCË

Qëllimi kryesor i vlerësimit është të mbështesë të nxënësit e nxënësve. Ky qëllim, së bashku me parimet e vlerësimit të nxënësve gjatë mësimit në distancë, duhet të udhëheqin procesin e vlerësimit të nxënësve në rrethanat e krijuara nga pandemia COVID-19.

Format e vlerësimit të nxënësve: vlerësimi i vazhduar, vlerësimi i portofolit dhe vlerësimi i testit/detyrës përmbledhëse, të përdorura nga mësuesit gjatë mësimit në kushtet e shtëpisë, duhet t'i shërbejnë përmbushjes së këtij qëllimi dhe të reflektojnë zbatimin e parimeve.



4.1 Vlerësimi i vazhduar për të nxënë (vlerësim formues)

Fokusi kryesor i vlerësimit të vazhduar për të nxënë (vlerësim formues) është që nxënësi të përmirësojë të nxënësit e tij dhe të motivohet më shumë për të mësuar. Gjatë vlerësimit të mësimit në distancë nxënësit kanë më shumë nevojë për mbështetje dhe informacion për të nxënësit e tyre se sa në klasat tradicionale.

Vlerësimi për të nxënë duhet të fokusohet në identifikimin e pikave të forta të nxënësve, të problemeve dhe vështirësive që ata kanë duke ofruar reagime të shpeshta dhe shpejta, të cilat i ndihmojnë nxënësit të mësojnë më mirë. Vlerësimi i vazhdueshëm është efektiv kur nxënësit e dinë ku janë me të nxënësit e tyre dhe çfarë se duhet të bëjnë më tej për ta përmirësuar atë.

Përmes vlerësimit të vazhduar, mësuesi duhet të sigurojë dhe t'u ofrojë nxënësve sa më shumë informacione mbështetëse, me gojë dhe me shkrim, dhe të sigurohet që nxënësit reflektojnë rreth tyre.

Procesi i mësimdhënie-nxënies, për pasojë dhe vlerësimi i nxënësve, *duhen përqendruar më së shumti në përmbajtjen thelbësore, në përsëritjen e njohurive dhe të aftësive të mësuara deri në periudhën e izolimit, si dhe në konceptet e reja kryesore.* Vlerësimi i nxënësve duhet të mbështetet tërësisht në rezultatet e të nxënësit të programeve mësimore. Mësuesi nuk ka të drejtë të vlerësojë nxënësit për ato rezultate që nuk janë në program.

Vlerësimi i nxënësve duhet të jetë i përqendruar në përmbajtjet kryesore, duke lënë mënjanë detaje të parëndësishme.

Metodat, teknikat dhe strategjitë e vlerësimit të vazhduar duhet të jenë të shumëllojshme dhe të përfshijnë pyetjet dhe përgjigjet e nxënësve, pjesëmarrjen në diskutime, vlerësimin e detyrave të shtëpisë, vlerësimin e problemeve që shtrijnë zgjidhje të situatave të jetës së përditshme, vetëvlerësimin e nxënësit etj., për t'i dhënë mundësi të gjithë nxënësve të shprehin sa më mirë arritjet e tyre.

- **Vlerësimi i vazhduar duhet të nxisë pjesëmarrjen aktive dhe vetëvlerësimin e nxënësve** për të reflektuar mbi të nxënësit e tyre. Shpesh ky vlerësim është informal dhe nxënësit mund të mbajnë edhe vetë shënime mbi progresin e tyre. Një shembull është një kuiz i shpejtë për të parë nëse nxënësit i kujtojnë pikat e rëndësishme të mësimin.
- **Vlerësimi i nxënësve me nevoja të veçanta** duhet të bëhet në mënyrë të tillë që t'u japë atyre mundësinë të demonstrojnë çfarë dinë dhe mund të bëjnë në përmbushje të rezultateve të të nxënësit.

Vlerësimi i nxënësve me aftësi të kufizuar

Orientimi i nxënësve në lidhje me detyrat e shtëpisë rekomandohet të jetë sipas një modeli pune të **diferencuar** dhe **individuale**. Në kushtet e mësimin në shtëpi, kur nxënësit mund të komunikojnë me njëri-tjetrin përmes platformave digjitale, kjo gjë synon shmangien e kopjimit të detyrës nga njëri-tjetri dhe rritjen e vlerësimit korrekt dhe transparent.

Vlerësimi i nxënësve me aftësi të kufizuar duhet të bëhet në mënyrë të tillë që t'u japë atyre mundësinë të demonstrojnë çfarë dinë dhe mund të bëjnë në përmbushje të rezultateve të të nxënësit. Mësuesi ndihmës në bashkëpunim me mësuesin e klasës/lëndës, prindin dhe psikologun e shkollës, vlerëson ecurinë e nxënësit me aftësi të kufizuar, bazuar në Planin Edukativ Individual (PEI). Gjatë vlerësimit të nxënësve me aftësi të kufizuar mund të bëhen edhe modifikime që përfshijnë Këto modifikime mund të përfshijnë:

- përshtatjen e formateve alternative të pyetje/përgjigjeve, p.sh., një formë të përgjigjes më të thjeshtuar (bazuar në disa pika orientuese) në vend të një eseje që duhet të përgatisin nxënësit;
- modifikime të veprimtarive vlerësuese, p.sh., duke thjeshtuar gjuhën e përdorur ose duke përdorur një format tjetër të pyeturi;
- përshtatje të procesit të vlerësimit, p.sh., duke i dhënë kohë shtesë nxënësit.

Procedurat dhe teknikat e vlerësimit për nxënësit me aftësi të kufizuar duhet të diskutohen herë pas here me prindërit, psikologun e shkollës dhe vetë nxënësit. Prindërit duhet të kuptojnë se si ndikojnë këto procedura dhe teknika të përshtatura në vlerësimin e punës së fëmijës së tyre.

4.2 Vlerësimi i portofolit

Portofoli i nxënësit është formë e vlerësimit të detyrave dhe të punimeve të kryera nga nxënësit, të cilat shërbejnë për të dëshmuar zhvillimin e kompetencave.

Mbani mend: Mësuesit duhet të bëjnë kujdes të mos i mbingarkojnë nxënësit me detyra dhe aq më tepër, me detyra që nuk mund të kryhen në kushtet e shtëpisë.

Çfarë duhet pasur parasysh në lidhje me planifikimin, realizimin dhe vlerësimin e portofolit?

- Mësuesi në bashkëpunim me nxënësit, përcaktojnë detyrat që do të përfshijnë në portofol, në varësi të specifikave të lëndës, si dhe të kushteve dhe mundësive që kanë nxënësit gjatë mësimin në kushtet e shtëpisë.
- Mësuesi përcakton kriteret e vlerësimit të portofolit dhe ua komunikon nxënësve dhe prindërve.
- Mësuesi përcakton afatet për realizimin e detyrave të portofolit dhe ua komunikon nxënësve dhe prindërve.
- Mësuesi udhëzon nxënësit që t'i ruajnë detyrat e portofolit deri në përfundim të vitit shkollor.

Reflektimet e mësuesit gjatë zhvillimit dhe vlerësimit të detyrave të portofolit e ndihmojnë nxënësin të kuptojë rezultatin dhe se ku duhet të punojë për ta përmirësuar atë. Reflektimet e mësuesit:

- duhet të jenë konstruktive në mënyrë që nxënësit të ndjehen të inkurajuar dhe të motivuar për t'u përmirësuar;
- duhet të jepen në kohën e duhur dhe jo vetëm në fund të detyrës, në mënyrë që nxënësit ta përdorin atë për të përmirësuar punën;
- duhet të jenë të fokusuar te arritjet dhe përpjekjet specifike të nxënësit pasi në këtë mënyrë sigurojnë informacion të dobishëm për të.

*Në kushtet e zhvillimit të mësimin në distancë, në rast se nxënësit nuk mund të kryejnë projektet kurrikulare, mësuesi **mund** ta zëvendësojë projektin kurrikular që ishte parashikuar të realizohej në grup me një detyrë individuale krijuese, zbatuese, hulumtuese, duke pasur gjithmonë parasysh kushtet dhe mundësitë specifike të nxënësve.*

Projekti kurrikular

Projekti kurrikular, si rubrikë e portofolit të të nxënësit, në kushtet e mësimin në distancë, do të menaxhohet në varësi të mundësive që kanë nxënësit për kryerjen e tij.

a) Në rastet kur nuk është i mundur zhvillimi dhe vlerësimi i tij, **sugjerohet që projekti kurrikular të zëvendësohet me një detyrë krijuese/hulumtuese individuale, e cila mund të zhvillohet në kushtet e shtëpisë.** Nëse zgjidhja e ushtrimeve, zhvillimi i detyrave apo realizimi i veprimtarive praktike kërkojnë që nxënësit të gjejnë informacion në burime të tjera të nxënësit, mësuesi orienton nxënësit për këto burime, si p.sh., adresa web, libra etj., duke bërë kujdes që të konsultohet paraprakisht me nxënësit për mundësitë që ata kanë për t'i siguruar ato.

b) Nëse **nxënësit kanë mundësi të komunikojnë dhe të bashkëpunojnë online midis tyre**, (kryesisht në arsimin e mesëm të lartë, por dhe në arsimin e mesëm të ulët) mësuesi në bashkëpunim me nxënësit, mund të vijojnë me realizimin e projekteve kurrikulare të planifikuara në grup. Për zhvillimin e tyre mësuesi:

- përcakton qartë detyrën mësimore në detaje për çdo grup dhe nxënësit (është mjaft e rëndësishme që secili nxënësit të jetë i përfshirë dhe i angazhuar me detyrën të përcaktuar);
- paraqet rezultatet e të nxënësit që do të arrihen nëpërmjet projektit;
- qartëson nxënësit për arritjen përfundimtare të projektit;
- qartëson nxënësit për kriteret e vlerësimit të projektit;
- vlerëson dhe jep gjykimin e tij në mënyrë të vazhdueshme për ecurinë e zbatimit të projektit.


4.3 Vlerësimi me test/detyrë përmbledhëse

Qëllimi kryesor i çdo testi/detyrë përmbledhëse është përcaktimi i asaj se çfarë nxënësit dinë dhe janë në gjendje të bëjnë. *Gjatë vlerësimit me test ose detyrë përmbledhëse të mësimin në distancë duhet të sigurohet informacioni i nevojshëm nëse përparimi i nxënësve është në rrugën e duhur apo duhen ndërmarrë hapa të tjerë për zgjidhjen e ndonjë problemi të mundshëm.*

Në kushtet e mësimin në distancë dhe në rastet kur nxënësit kanë mundësi teknologjike, mësuesit mund të zhvillojnë me nxënësit test ose detyrë përmbledhëse me shkrim ose me gojë.

Në kushtet e zhvillimit të mësimin në distancë, në rast se nxënësit nuk mund të kryejnë testet apo detyrat përmbledhëse, mësuesi mund të vijojë vlerësimin me format e tjera të vlerësimit.

Për hartimin e testit ose detyrës përmbledhëse që kryhet në kushtet e mësimit në distancë mësuesi përcakton rezultatet e të nxënës dhe njohuritë kryesore që janë zhvilluar për periudhën që vlerësohet. *Testi/detyra përmbledhëse nuk duhet të jetë e mbingarkuar dhe të synojë vlerësimin e të gjitha çështjeve që nxënësi ka zhvilluar. Nuk duhet të harrojmë që ky lloj vlerësimi është një ndër format e vlerësimit. Për monitorimin e progresit dhe matjen e arritjeve të nxënësve, mësuesi përdor dhe format e tjera të vlerësimit.*



Mësuesit e lëndëve të fushave: Gjuhët dhe komunikimi, “Matematikë” dhe “Shkencat e natyrës” vendosin nëse do të zhvillojnë me nxënësit teste ose detyra përmbledhëse me shkrim ose me gojë (sipas specifikave të lëndës).

Mësuesit e lëndëve të fushave: “Shoqëria dhe mjedisi”, “Arte”, “Teknologji dhe TIK”, “Edukim fizik, sporte dhe shëndet” etj., **NUK zhvillojnë teste**, por detyra përmbledhëse me shkrim ose me gojë, në mënyrë që nxënësit të mos ngarkohen me teste për të gjitha lëndët.

Mësuesit duhet të jenë të kujdesshëm të mos ngarkojnë nxënësit me teste të tepërta për të mos krijuar tension te nxënësit.

Testet/detyrat përmbledhëse duhet të nxisin të menduarin kritik e krijues, zgjidhjen e situatave problemore dhe të përfshijnë pyetje të llojeve të ndryshme: pyetje me zgjedhje të shumëfishtë, pyetje me kombinime, pyetje të strukturuar dhe të hapura, të cilat nuk e vendosin fokusin në riprodhimin e fakteve dhe informacionit. Kjo mundëson që në kushtet e zhvillimit të testit/detyrës përmbledhëse në distancë, të kontrollohet jo vetëm saktësia e përgjigjeve, por edhe procesi i zgjidhjes së kërkesave/pyetjeve.

Kërkesat që shtrohen për vlerësimin e nxënësve në test duhet të sigurojnë standardet për të tria nivelet e vështirësive kaluese (niveli 2, 3 dhe 4 – referuar niveleve të arritjeve ⁶), si dhe të marrin parasysh veçoritë e nxënësve, përfshirë ato të nxënësve me nevoja të veçanta. Nëse do të hartojmë një test me kërkesa/pyetje kryesisht të nivelit 2 (niveli bazë), atëherë nuk do t’u jepnim mundësi nxënësve të shfaqnin siç duhet aftësitë e tyre. E njëjta gjë do të ndodhte nëse do të hartoheshin kryesisht dhe vetëm kërkesa/pyetje të nivelit 4 (niveli i lartë). Në rastin e parë ne nuk do të jemi të drejtë me nxënësit me arritje të larta, ndërsa në rastin e dytë nxënësit me arritje më të ulëta.

Për zhvillimin e testit ose të detyrës përmbledhëse, mësuesi përcakton:

- datën e zhvillimit të testit/detyrës përmbledhëse;
- orarin e zhvillimit të testit/detyrës përmbledhëse;
- kohën sa do të zgjasë testi/detyra përmbledhëse;
- mënyrën e organizimit të testit/detyrës përmbledhëse.

Mësuesit duhet t’i kushtojnë kujdes të veçantë komunikimit të ndërsjellë me nxënësit dhe me prindërit. Para zhvillimit të testit/detyrës përmbledhëse dhe pas vlerësimit të tij, mësuesi i sqaron nxënësit, duke iu përgjigjur me kujdes çdo pyetjeje apo paqartësie që ata mund të kenë lidhur me testin/detyrën përmbledhëse, si dhe shpjegon ku duhen përmirësuar në të ardhmen.

⁶ Niveli 1 është jo kalues.

5. ROLET DHE PËRGJEGJËSITË NË VLERËSIMIN NË DISTANCË

Në kushtet e mbylljes së shkollave, mësuesit po zbatojnë mënyra të reja të procesit të vlerësimit të procesit të të nxënës, nxënësit po përballen me mënyra të reja të nxënies dhe të vlerësimit, si dhe shumë prindër po e gjejnë veten me një titull të ri, të papritur dhe sfidues “Mësues”.

Situata e krijuar nga COVID-19 ka ndërgjegjësuar të gjithë qytetarët, por mbi të gjitha **bashkëpunimi mësues – prindër – nxënës në këtë situatë po merr një përmasë më të madhe**. Procesi i shkëmbimit të informacionit ndërmjet këtij trinomi, si dhe **procesi i vlerësimit nëpërmjet rrjeteve sociale, platformave të ndryshme online** është më i miri i mundshëm që mund të realizohet në këto kushte, në mënyrë që fëmijët të vijnë me marrjen e njohurive dhe të aftësive që kërkon kurrikula deri në përfundim të vitit shkollor.

Nga ana tjetër, prindërit nuk janë mësues dhe mund të ndjehen të mbingarkuar nga presioni për t’i ndihmuar fëmijët e tyre që të përvetësojnë njohuritë dhe aftësitë e nevojshme gjatë kohës që shkollat janë mbyllur. Megjithatë në këto momente, klasa virtuale dhe komunikimi online i nxënësve me mësuesit dhe shokët e tyre është mënyra e vetme për të përmbyllur procesin e mësimit.

Ndërveprimi mes mësuesve dhe nxënësve është shumë i rëndësishëm në procesin mësuesor online pasi inkurajon të nxënës e nxënësve.

Grupet që kanë role kryesore gjatë mësimit në distancë mund të kategorizohen si më poshtë:

MËSUESIT	NXËNËSIT	PRINDËRIT
Roli kryesor i mësuesit është hartimi i përmbajtjes dhe përcaktimi i nevojave të nxënësve. Mësuesi ka rolin për të lehtësuar dhe për të drejtuar nxënësit.	Në mësimin në distancë, roli kryesor i nxënësve është të nxënës. Në këtë proces, nxënësi ka role të vështira dhe të ndryshme nga procesi tradicional i mësimit dhe i formave të të nxënës.	Gjatë mësimit në distancë, prindërit janë përgjegjës për të krijuar mjedisin dhe kushtet që fëmijët e tyre të nxënë në mënyrë sa më efektive.

5.1 Roli i mësuesit për vlerësimin gjatë mësimit në distancë

Mësuesi është lehtësues, udhëzues dhe monitoron nxënësit, veçanërisht në procesin e vlerësimit. Më poshtë listohen disa përgjegjësi të mësuesit për vlerësimin gjatë mësimit në distancë.

Mësuesi:

- kujdeset për mirëqenien psiko-emocionale të nxënësve
- informon nxënësit për respektimin e rregullave të sjelljes etike gjatë zhvillimit të mësimit online në platforma të ndryshme;
- informon nxënësit që të jenë të vetëdijshëm për dallimet individuale ndërmjet tyre, si dhe për hartimin e materialeve mësimore të përshtatshme;
- planifikon përmbajtje mësimore me informacion real dhe aktual për të transmetuar dije duke i konkretizuar me shembuj;
- kryen vlerësime në mënyrë periodike, si pjesë e vazhdueshme e procesit të të nxënës dhe mësimit;
- siguron që vlerësimi i nxënësit të mbështesë të nxënës dhe të bazohet në një bazë të dhënash, të cilat gjykohen përkundrejt rezultateve të pritshme duke nxitur progresin e nxënësit;
- përfshin nxënësit plotësisht në procesin e vlerësimit dhe i ndihmon ata të kuptojnë çfarë pritët prej tyre;

- vlerëson të dhënat e të nxënësve për të kontribuar në raportimin e arritjeve të nxënësve dhe në progresin e tyre;
- vlerëson pjesëmarrjen dhe angazhimin e nxënësve gjatë mësimin në distancë;
- i jep shumë rëndësi mendimeve të nxënësve duke i motivuar ata për vetëzhvillim në mënyrë që të vlerësojnë përvojat e tyre mbi përmbajtjet mësimore;
- duhet të përdorë teknologjinë për të zbatuar në mënyrë efektive mësimin në distancë, duke vijuar procesin e të nxënësve me në qendër nxënësin;
- u përgjigjet pyetjeve që i adresojnë nxënësit në lidhje me përmbajtjen mësimore;
- siguron mjedisin e të mësuarit bashkëpunues;
- informon prindërit në kohë dhe në mënyrë të vazhdueshme për suksesin dhe vështirësitë e fëmijëve të tyre dhe i udhëzon ata si të ndikojnë në përmirësimin e rezultateve;
- kujdeset për besueshmërinë e informacioneve dhe përdorimin e drejtës të tyre;
- reflekton dhe jep vazhdimisht sugjerime dhe komente për përmirësimin e nxënësve;
- zgjedh formën dhe mënyrën e komunikimit në grup me nxënësit dhe prindërit e tyre për instrumentet e përdorura gjatë procesit të vlerësimit p.sh., detyra, ushtrime, lexime plotësuese etj.
- bën kujdes të mos mbingarkojë nxënësit duke përdorur instrumente vlerësimi të ndryshme në të njëjtën kohë;
- informon drejtorinë e shkollës lidhur me ecurinë e zhvillimit të mësimin në kushtet e shtëpisë, si dhe të procesit të vlerësimit të nxënësve.

5.2 Roli i nxënësit për vlerësimin gjatë mësimin në distancë

Mësimi online në kushtet e shtëpisë, megjithëse nuk mund ta zëvendësojë mësimin në klasë, ka krijuar mundësi që nxënësit të punojnë dhe të krijojnë të pavarur në kushtet e shtëpisë duke përdorur burime digjitale alternative. Sot nxënësit rriten me teknologji dhe ky burim është lehtësisht i përdorshëm për ta. Më poshtë listohen disa përgjegjësi të nxënësit gjatë mësimin në distancë.

Nxënësi:

- angazhohet aktivisht në procesin e të nxënësve duke treguar përgjegjësi në zhvillimin e detyrave;
- respekton rregullat etike të komunikimit online;
- vlerësohet si pjesë e të nxënësve të përditshëm përmes një sërë veprimtarish: kërkime praktike, demonstrime, prezantime me gojë, diskutime etj., përfshirë edhe dialogun dhe ndërveprimin me bashkëmoshatarët dhe mësuesit;
- vlerësohet përmes punëve me shkrim dhe produkteve të tilla, si: veprimtari krijuese, raporte, projekte;
- rishikon të nxënësve të tij përmes vetëvlerësimit dhe vlerësimit nga shokët e tij;
- kontribuon në moderimin e vlerësimit duke gjykuar mbi arritjet e tij;
- këshillohet me mësuesin për vështirësitë duke i drejtuar pyetje mbi vështirësitë e tij;
- ndërmerr iniciativë për të kryer detyra hulumtuese, për të zgjidhur probleme, për të kryer përpunimin e informacionit etj.

5.3 Roli i prindërve për vlerësimin gjatë mësimin në distancë

Gjatë mësimin në distancë, prindërit kanë një rol të rëndësishëm për të mbështetur fëmijët e tyre në kryerjen e detyrave, si dhe në procesin e vlerësimit të tyre. Ata përshtatin oraret e tyre për të përmbushur nevojat e fëmijëve, duke i ndihmuar në çështjet e përmbajtjes, por edhe duke i


mësuar të jenë pavarur. Prindërit nuk mund të zëvendësojnë gjithçka që bëhej në shkollë por ata janë trajnerët më të mirë të jetës së fëmijëve.

Prindërit:

- janë pjesë e grupeve të komunikimit me mësuesit për të marrë sa më shumë informacion lidhur me procedurat e mësimit në distancë, sipas kushteve;
- janë pjesë e vendimeve për mënyrën e organizimit të mësimit në distancë, si dhe për vlerësimin e fëmijëve të tyre;
- krijojnë kushtet dhe mjedisin që fëmijët e tyre të marrin pjesë rregullisht në mësimin në distancë;
- përfshihen aktivisht në mbështetje të të nxënësve të fëmijëve dhe të angazhimit të tyre në zhvillimin e detyrave;
- marrin informacion të rregullt rreth anëve të forta të fëmijëve të tyre, progresit dhe arritjeve të tyre;
- informohen për boshllëqet dhe mënyrat përmes të cilave mund t'u vinë në ndihmë fëmijëve të tyre;
- mbështesin fëmijën në mësimin në kushtet e shtëpisë duke lehtësuar marrjen e informacionit nga mësuesit.

5.4 Raportimi për ecurinë e nxënësve gjatë procesit të mësimit në distancë

Raportimi u siguron prindërve informacion të rregullt për arritjet (anët e forta) të fëmijëve të tyre dhe nevojat e zhvillimit, mundësi për të diskutuar mbi progresin në aspekte të ndryshme të kurrikulës, si dhe mundësi për të dhënë mendimin e tyre mbi progresin e fëmijëve. Raportimi i progresit dhe i arritjeve të nxënësve i vjen në ndihmë prindërve të kuptojnë si mund të mbështesin fëmijët e tyre në procesin e të nxënësve në kushtet e shtëpisë.



- Raportimi duhet të identifikojë përparimin dhe dobësitë, përshkrimin e tyre, si dhe të theksojë pikat strategjike të mundshme për përmirësimin e arritjeve. Dhënia e komenteve mund të jetë me gojë ose me shkrim; raportimi duhet të jetë konstruktiv dhe pozitiv; të identifikojë çfarë ka bërë nxënësi mirë ose jo mirë; çfarë duhet bërë për përmirësim; si duhet bërë; si dhe të sugjerohen hapat e mëtejshëm.

- *Për t'i ndihmuar prindërit të mbështesin fëmijët e tyre në procesin e të nxënës, është e rëndësishme që mësuesit të ndajnë informacionin e plotë dhe të hapur të progresit të çdo nxënësi. Në momente të veçanta, mësuesit punojnë me nxënësit për të përmbledhur dhe raportuar arritjet, duke përdorur komente të shkurtra cilësore për të nxënës dhe planifikuar në fusha të të nxënës dhe në kontekste të ndryshme. Raportimi duhet të theksojë anët e forta, aspektet për zhvillim dhe arritjet në aspektet sfiduese.*
- *Gjithashtu, është e rëndësishme që për nxënësit që kërkojnë më shumë mundësi, apo për nxënësit me nevoja të veçanta, raportimi të përshkruajë një balancë të përshtatshme midis thellësisë së të nxënës dhe aspekteve sfiduese. Mësuesit duhet të bëjnë të qartë natyrën e mbështetjes që duhet të ofrohet me qëllim që çdo nxënës të ketë progres.*
- *Mësuesi raporton gjithashtu edhe për pjesëmarrjen e rregullt të nxënës gjatë mësimit në distancë, angazhimin e tij në kryerjen e detyrave, aktivizimin gjatë zhvillimit të mësimit online, si dhe cilësinë e realizimit të detyrave.*

Puna në partneritet efektiv rrit vlefshmërinë, besueshmërinë dhe përmirëson cilësinë e zhvillimit të mësimit në distancë.

5.5 Reagimi i shkollave lidhur me mësimin në distancë

Mësimi në distancë është një sfidë e madhe, e papritur, por e realizueshme.

Gjatë sondazheve të realizuara, shkollat kanë dërguar disa shembuj pozitivë nga praktika e mësimit në distancë.

Drejtuesit e shkollave - Mësuesit dhe nxënësit janë të kënaqur, por veçanërisht nxënësit sepse mësimi në distancë është tërheqës për ta.

Drejtuesit e shkollave - Ne jemi të surprizuar për mënyrën se si mësuesit po përdorin platformat online dhe se si e kanë përshtatur punën e tyre nëpërmjet këtyre platformave.

Mësuesit - Prindërit tani janë më të përfshirë në procesin e mësimit, ata u japin përgjigje mësuesve dhe paraqesin punën e bërë nga nxënësit.

Prindërit - Atmosfera (brenda dhe rreth mësimit në distancë) është e qetë dhe realizimi i detyrave të përditshme ka forcuar frymën e bashkëpunimit.

Mësuesit - Mund të krijojmë mësim, kuize dhe të përdorim platforma të ndryshme.

Mësuesit - Gjithmonë kemi parasysh se të gjithë duhet të veprojmë me përgjegjësi në krizën aktuale.

Mësimi online në kushtet e shtëpisë i ka bërë mësuesit të ndjekin më shumë platforma trajnimi online duke zhvilluar kapacitetet e tyre profesionale në këtë fushë. Trajnimi i mësuesve në zhvillimin e kompetencave digjitale nga njëra anë ka qenë një nga fushat më prioritare për të zhvilluar shkollat e shekullit XXI, por nga ana tjetër është pjesa më e vështirë për mësuesit. Mësimi digjital është e ardhmja për shkollat e shekullit XXI dhe me gjithë përballjen e menjëhershme të mësuesve me këtë lloj mësimi, ai do të shërbejë në të ardhmen si burim i rëndësishëm i procesit të të nxënës.

6. MBYLLJA E VITIT SHKOLLOR 2019-2020

Në këtë kapitull jepen disa orientime në lidhje me vijueshmërinë e mësimit në shkollë deri në përfundim të vitit shkollor, me realizimin e programit lëndor të klasës përkatëse, si dhe me procedurat e vlerësimit përfundimtar të nxënësve në funksion të përmbushjes së kërkesave të kurrikulës.

KLASAT 1 - 11	KLASA 12
Mësimi në distancë do të vijojë deri në datën 29 maj 2020, duke u bazuar në planin mësimor dhe në orarin mësimor të hartuar nga secila shkollë për lëndët dhe klasat përkatëse.	Nxënësit e klasës së 12-të, do të kthehen në mjediset e shkollës në periudhën 18 maj - 5 qershor. Nxënësit do të zhvillojnë vetëm lëndët e provimeve të detyruara të Maturës Shtetërore.

6.1 Vijueshmëria dhe realizimi i programit mësimor në përfundim të vitit shkollor, për klasat 1-11

- Mësimi në distancë do të vijojë deri në përfundim të vitit shkollor në datë 29 maj 2020, duke u bazuar në planin mësimor dhe në orarin mësimor të hartuar nga secila shkollë për lëndët dhe klasat përkatëse.
- Provimet kombëtare të arsimit bazë, si dhe vlerësimi i arritjeve të nxënësve të arsimit fillor për këtë vit shkollor, nuk do të zhvillohen.
- Mësuesit, edhe për periudhën e tretë (prill – maj), ndjekin orarin mësimor të hartuar nga drejtoria e shkollës, duke mbajtur shënim temën e zhvilluar për çdo orë mësimi në kushtet e shtëpisë, si dhe pjesëmarrjen e nxënësve.
- Mësuesi realizon temat mësimore sipas planifikimit në planin e periudhës së tretë (prill – maj), duke u përqendruar në njohuritë kryesore, në orët e përsëritjes ose në zbatimin e njohurive.
- Pas përfundimit të vitit shkollor, në momentin e rikthimit në punë (gjatë muajit qershor), mësuesit shënojnë në regjistrin e klasës, temat e realizuara gjatë mësimit në kushtet e shtëpisë, numrin e orëve të realizuara për gjithë vitin shkollor, si dhe numrin e orëve të parealizuara.
- Nëse mësuesit kanë tema të parealizuara, i shënojnë në një evidencë dhe i dorëzojnë te drejtori i shkollës. Këto tema do të zhvillohen gjatë vitit të ri shkollor 2020-2021 sipas udhëzimeve që do të hartohen më pas.
- Mësuesit llogarisin mungesat vjetore të nxënësve në çdo lëndë, si dhe mungesat totale vjetore.
- Mësuesit plotësojnë evidencat e statistikave të kërkuara nga drejtoria e shkollës mbi rezultatet e nxënësve, frekuentimin e tyre etj., dhe ia dorëzojnë asaj.
- Drejtoria e shkollës krijon kushtet në shkollë për plotësimin e dokumentacionit shkollor: të regjistrave sipas klasave, të dëftesave të nxënësve, të amzave të shkollës etj.
- Drejtorët e shkollave raportojnë mbi mbylljen e vitit shkollor 2019-2020 në ZVA, lidhur me rezultatet dhe problematikat.
- ZVA-të raportojnë në DRAP dhe në DPAP, lidhur me rezultatet dhe problematikat.

6.2 Vijueshmëria dhe realizimi i programit mësimor në përfundim të vitit shkollor, klasa e 12-të

- a) Nxënësit e klasës së 12-të do të përfundojnë vitin shkollor 2019-2020 në datën 5 qershor, sipas afateve të përcaktuara në strukturën e vitit shkollor 2019 -2020.
- b) Provimet e Maturës Shtetërore do të zhvillohen në periudhën 8-18 qershor 2020.
- c) Nxënësit e klasës së 12-të do të vijojnë mësimin në distancë deri në datën 15 maj 2020. Maturantët do të mbyllin lëndët që NUK kanë provime të Maturës Shtetërore deri në deri në 30 prill 2020.
- d) Nxënësit e klasës së 12-të në periudhën 4 maj - 15 maj 2020, gjatë mësimin në distancë do të zhvillojnë vetëm lëndët e provimeve të detyruara të Maturës Shtetërore: Gjuhë shqipe dhe Letërsi, Matematikë, Gjuhë e huaj e parë, si dhe lëndën që kanë zgjedhur në provimin me zgjedhje të Maturës Shtetërore. Shkollat do të përshtatin orarin për zhvillimin e këtyre lëndëve online.
- e) Nxënësit e klasës së 12-të, do të kthehen në shkollë në periudhën 18 maj – 5 qershor 2020 dhe do të zhvillojnë vetëm lëndët e provimeve të detyruara të Maturës Shtetërore: Gjuhë shqipe dhe Letërsi, Matematikë, Gjuhë e huaj e parë, si dhe lëndën që kanë zgjedhur në provimin me zgjedhje të Maturës Shtetërore. Gjatë kësaj periudhe do të zhvillohet vetëm përsëritje duke u bazuar në programet orientuese të këtyre lëndëve.
- f) Mësuesit gjatë mësimin në distancë ndjekin orarin mësimor të hartuar nga drejtoria e shkollës, duke mbajtur shënim temën e zhvilluar për çdo orë mësimi dhe pjesëmarrjen e nxënësve.
- g) Të gjithë mësuesit dhe maturantët mund të gjejnë në faqen zyrtare të ASCAP-it programet orientuese të rishikuara, ku janë hequr të gjitha njohuritë e zhvilluara pas datës 9 mars, gjatë mësimin në kushtet e shtëpisë.
- h) Gjatë periudhës së kthimit në shkollë, mësuesit e lëndëve të provimeve të Maturës Shtetërore do t'i shënojnë në regjister temat e përsëritjes që do të zhvillojnë me nxënësit maturantë.
- i) Mësuesit e lëndëve të tjera që nuk janë provime të Maturës Shtetërore, do të mbyllin realizimin e programit mësimor deri në datën 30 prill 2020.
- j) Të gjithë mësuesit do të shënojnë në regjistrin e klasës temat që kanë realizuar, numrin e orëve të realizuara për gjithë vitin shkollor, si edhe numrin e orëve të porealizuara.
- k) Për nxënësit maturantë do të llogariten mungesat vjetore të nxënësve në çdo lëndë, si dhe mungesat totale vjetore.

6.3 Organizimi i mësimin për klasën e 12-të gjatë kthimit në mjediset e shkollës

- a) Procesi mësimor gjatë periudhës së kthimit në mjediset e shkollës do të zhvillohet sipas parimit të distancimit social.
- b) Drejtoria e shkollës merr masa për higjienizimin e shkollës dhe respektimin e kërkesave sipas “Protokollit për qëndrimin dhe lëvizjet në shkollë (COVID-19)”.

- c) Drejtoria e shkollës riorganizon klasat e 12-ta sipas lëndës së provimit me zgjedhje.
- d) Drejtoria e shkollës përgatit listat e emrave të maturantëve sipas ndarjes së re deri në datë 15 maj.
- e) Gjatë periudhës së kthimit në shkollë, drejtoria merr masa që stafi i shërbimit psiko-social dhe stafi i shërbimit mjekësor të jenë të pranishëm në shkollë dhe të kujdesen për mirëqenien e nxënësve. Stafi i shërbimit psiko-social organizon takime me nxënës që ditën e parë të kthimit në shkollë duke krijuar një klimë të ngrohtë dhe bashkëpunuese.
- f) *Gjatë periudhës së kthimit në shkollë, drejtoria e shkollës harton orarin e ri mësimor dhe e përshtat atë që nxënësit të zhvillojnë vetëm orë mësimi në lëndët e provimeve të Maturës Shtetërore. Pra, çdo ditë mësimi do të zhvillohen lëndët: Gjuhë shqipe/Letërsi, Matematikë, Gjuhë e huaj e parë, si dhe lënda që nxënësi ka zgjedhur si provim me zgjedhje.*
- g) Të gjithë mësuesit që japin mësim në maturë, gjatë muajit qershor do të plotësojnë evidencat e statistikave të kërkuara nga drejtoria e shkollës mbi rezultatet e nxënësve, frekuentimin e tyre etj., dhe do t'i dorëzojnë te stafi drejtues.
- h) Drejtoria e shkollës, gjatë muajit qershor, krijon kushtet në shkollë për plotësimin e dokumentacionit shkollor si: të regjistrave sipas klasave, të certifikatave të maturës shtetërore të nxënësve, të amzave të shkollës etj.
- i) Drejtorët e shkollave raportojnë mbi mbylljen e vitit shkollor në ZVA, lidhur me rezultatet dhe problematikat për punën me nxënësit maturantë.
- j) ZVA-të raportojnë në DRAP dhe në DPAP, lidhur me rezultatet dhe problematikat për punën me nxënësit maturantë.

6.4 Procedurat e vlerësimit të nxënësve në klasat 1-12

Vlerësimi i angazhimit të nxënësit gjatë gjithë mësimi në distancë
Vlerësimi i portofolit
Vlerësimi me test/detyrë përmbledhëse
Vlerësimi i vazhduar

6.4.1 Procedurat e vlerësimit të periudhës së tretë (prill – maj)

- a) Gjatë periudhës së tretë (prill – maj), mësuesit do të vijnë të mbajnë shënime në fletoren personale për vlerësimin e detyrave që ka kryer nxënësi, për gatishmërinë dhe angazhimin të tij për të komunikuar me mësuesin dhe për të marrë pjesë në mësimin online në kushtet e shtëpisë.
- b) Gjatë periudhës së tretë (prill – maj) nxënësi NUK do të vlerësohet me notë në regjister për vlerësimin e vazhduar, vlerësimin e portofolit dhe vlerësimin me test/detyrë përmbledhëse, ***por mbështetur në pjesëmarrjen dhe në angazhimin e nxënësit gjatë mësimi në kushtet e shtëpisë, mësuesi mund të rrisë një notë në vlerësimin përfundimtar të nxënësit.***

6.4.2 Shënimi i vlerësimeve në regjistër

- a)** Për periudhën e dytë (janar – mars) mësuesit hedhin në kolonat përkatëse, vlerësimet që kanë kryer dhe që i kanë raportuar në drejtorinë e shkollës, te prindërit dhe te nxënësit.
- b)** Në rastet e veçanta, kur mësuesit gjatë periudhës së dytë (janar – mars) nuk kanë arritur të përfundojnë vlerësimin me test/detyrë përmbledhëse ose/dhe vlerësimin e portofolit për shkak të pamundësisë së nxënësve për t'u lidhur online me mësuesit e tyre në mënyrë të vazhdueshme, atëherë në kolonën e vlerësimit me test/detyrë përmbledhëse, si dhe në kolonën e vlerësimit të portofolit do të shënohet NK (Nuk u krye) dhe kjo notë nuk do të llogaritet në vlerësimin vjetor për notën e *testit/detyrës përmbledhëse apo për notën e vlerësimi të portofolit*.
- c)** Në periudhën e tretë (prill – maj) në regjistër, në kolonën e vlerësimit të vazhduar, të vlerësimit me test/detyrë përmbledhëse dhe të vlerësimit të portofolit do të shënohet NK (Nuk u krye) dhe kjo notë nuk do të llogaritet *në vlerësimin vjetor për notën e vlerësimit të vazhduar, në vlerësimin vjetor për notën e vlerësimit testit/detyrës përmbledhëse, si dhe në vlerësimin vjetor për notën e portofolit*.

6.4.3 Procedurat e vlerësimit përfundimtar

Vlerësimi përfundimtar për vitin shkollor 2019 - 2020 nuk duhet të jetë thjesht një llogaritje numrash, por duhet të merret në konsideratë edhe gjendja psikologjike, fizike dhe sociale e nxënësve, angazhimi i tyre gjatë mësimit në kushtet e shtëpisë dhe mbi të gjitha ecuria dhe vlerësimet që nxënësi ka marrë kur ka qenë në shkollë. Mësuesit duhet të jenë fleksibël në vlerësimet përfundimtare të nxënësve.

Për vlerësimin përfundimtar janë parashikuar tre skenarë si më poshtë:

Skenari 1: Rastet kur mësuesit kanë plotësuar të tria vlerësimet për dy periudhat e para (shtator – dhjetor dhe janar – mars).

Skenari 2: Rastet e veçanta kur mësuesit NUK kanë mundur të kryejnë vlerësimin me test/detyrë përmbledhëse dhe vlerësimin e portofolit për periudhën e dytë (janar – mars).

Skenari 3: Rastet e veçanta kur mësuesit NUK kanë mundur të kryejnë vetëm vlerësimin me test/detyrë përmbledhëse për periudhën e dytë (janar – mars).

6.4.3.1 Nxënësit në klasat 1-3

Vlerësimi përfundimtar do të kryhet sipas ndarjes më poshtë:

a) Vlerësimi i vazhduar përbën 45% të vlerësimit përfundimtar. Ky vlerësim do të mbështetet në përgatitjen e detyrave që nxënësi ka zhvilluar në shtëpi dhe në klasë gjatë kohës së mësimit në shkollë përfshirë edhe detyrat që ka zhvilluar gjatë periudhës së qëndrimit në shtëpi si dhe përgjigjet me gojë.

b) Vlerësimi i punimeve dhe i detyrave krijuese të nxënësit përbën 25% të vlerësimit përfundimtar dhe përmban punën e pavarur dhe krijuese të nxënësit, bashkëpunimin me nxënësit e tjerë, pjesëmarrjen në detyra krijuese dhe veprimtari të tjera që mund të zhvillohen në distancë.

c) Vlerësimi me testime përbën 30% të vlerësimit përfundimtar. Testimet për lëndën e gjuhës shqipe dhe për lëndën e matematikës do të zhvillohen me teste të thjeshta dhe të shkurtra, të realizuara vetëm pas organizimit të përsëritjes.

Shënim. Skenarët për vlerësimin përfundimtar të nxënësit përshtaten edhe për klasat 1-3

6.4.3.2 Nxënësit në klasat 4 – 12

Për vlerësimin përfundimtar janë parashikuar tre skenarë si më poshtë:

Skenari 1: Rastet kur mësuesit kanë plotësuar të tria vlerësimet për dy periudhat e para (shtator – dhjetor dhe janar – mars).

a) Vlerësimet vjetore përmbajnë:

- Notën vjetore të vlerësimit të vazhduar
- Notën vjetore të vlerësimit me test ose me detyrë përmbledhëse
- Notën vjetore të vlerësimit të portofolit

b) Hapat për njehsimin e notës përfundimtare janë:

- Përcaktohet nota vjetore e vlerësimit të vazhduar (NVv), bazuar në **dy notat e dy periudhave të para (shtator – dhjetor dhe janar – mars)**, duke gjykuar në mënyrë progresive ose me mesatare aritmetike.
- Përcaktohet nota vjetore e testit/detyrës përmbledhëse (NTp) bazuar në **dy notat e dy periudhave të para (shtator – dhjetor dhe janar – mars)**, duke gjykuar në mënyrë progresive ose me mesatare aritmetike.
- Përcaktohet nota vjetore e portofolit të nxënësit (NVp) bazuar në **dy notat e dy periudhave të para (shtator – dhjetor dhe janar – mars)**, duke gjykuar në mënyrë progresive ose me mesatare aritmetike.
- Shumëzohet secila prej notave me përqindjen përkatëse.
- Mblidhen këto prodhime dhe shuma rumbullakoset me numër të plotë.

c) Në përfundim të vitit shkollor nxënësi ka **6 nota**, të cilat për shkak të situatës së krijuar nga pandemia COVID- 19, janë të mjaftueshme për të nxjerrë notën përfundimtare.

Shembull. Nëse një nxënës i klasës së tetë në lëndën e matematikës ka këto nota:

	NVv	NTp	NVp
Periudha e parë (Shtator – Dhjetor)	8	7	9
Periudha e dytë (Janar – Mars)	9	8	10
Periudha e tretë (Prill – Maj)	NK	NK	NK
Vlerësimet vjetore	9	8	10
Vlerësimi përfundimtar	$(NVv \times 0.4) + (NTp \times 0.4) + (NVp \times 0.2) =$ $(9 \times 0.4) + (8 \times 0.4) + (10 \times 0.2) =$ $3.6 + 3.2 + 2 = 8.8 \approx 9$		

Skenari 2: Rastet e veçanta kur mësuesit NUK kanë mundur të kryejnë vlerësimin me test/ detyrë përmbledhëse dhe vlerësimin e portofolit për periudhën e dytë (janar – mars).

a) Vlerësimet vjetore përmbajnë:

- Notën vjetore të vlerësimit të vazhduar
- Notën vjetore të vlerësimit me test ose me detyrë përmbledhëse
- Notën vjetore e vlerësimit të portofolit

b) Hapat për njehsimin e notës përfundimtare janë:

- Përcaktohet nota vjetore e vlerësimit të vazhduar (NVv), bazuar në **dy notat e dy periudhave**

të para (shtator – dhjetor dhe janar – mars), duke gjykuar në mënyrë progresive ose me mesatare aritmetike.

- Përcaktohet nota vjetore e testit/detyrës përmblendhëse (NTp), bazuar në **rezultatit e periudhës së parë (shtator – dhjetor)**.
- Përcaktohet nota vjetore e portofolit të nxënësit (NVp), bazuar në **rezultatit e periudhës së parë (shtator – dhjetor)**.
- Shumëzohet secila prej notave me përqindjen përkatëse.
- Mblidhen këto prodhime dhe shuma rrumbullakoset me numër të plotë.

c) Në përfundim të vitit shkollor nxënësi ka 4 nota, të cilat për shkak të situatës së krijuar nga pandemia COVID- 19 dhe në kushtet e pamundësisë së realizimit të detyrave online në mënyrë të vazhdueshme, janë të mjaftueshme për të nxjerrë notën përfundimtare.

Shembull. Nëse një nxënës i klasës së tetë në lëndën e matematikës ka këto nota:

	NV _v	NT _p	NV _p
Periudha e parë (Shtator – Dhjetor)	8	7	9
Periudha e dytë (Janar – Mars)	9	NK	NK
Periudha e tretë (Prill – Maj)	NK	NK	NK
Vlerësimet vjetore	9	7	9
Vlerësimi përfundimtar	$(NV_v \times 0.4) + (NT_p \times 0.4) + (NV_p \times 0.2) =$ $(9 \times 0.4) + (7 \times 0.4) + (9 \times 0.2) =$ $3.6 + 2.8 + 1.8 = 8.2 \approx 8$		

Skenari 3: Rastet e veçanta kur mësuesit NUK kanë mundur të kryejnë vetëm vlerësimin me test/detyrë përmblendhëse⁷ për periudhën e dytë (janar – mars).

a) Vlerësimet vjetore përmbajnë:

- Notën vjetore të vlerësimit të vazhduar
- Notën vjetore të vlerësimit me test ose me detyrë përmblendhëse
- Notën vjetore e vlerësimit të portofolit

b) Hapat për njehsimin e notës përfundimtare janë:

- Përcaktohet nota vjetore e vlerësimit të vazhduar (NV_v), bazuar në **dy notat e dy periudhave të para (shtator – dhjetor dhe janar – mars)**, duke gjykuar në mënyrë progresive ose me mesatare aritmetike.
- Përcaktohet nota vjetore e testit/detyrës përmblendhëse (NT_p), bazuar **në rezultatit e periudhës së parë (shtator – dhjetor)**.
- Përcaktohet nota vjetore e portofolit të nxënësit (NV_p), bazuar në **dy notat e dy periudhave të para (shtator – dhjetor dhe janar – mars)**, duke gjykuar në mënyrë progresive ose me mesatare aritmetike.
- Shumëzohet secila prej notave me përqindjen përkatëse.
- Mblidhen këto prodhime dhe shuma rrumbullakoset me numër të plotë.

c) Në përfundim të vitit shkollor nxënësi **ka 5 nota**, të cilat për shkak të situatës së krijuar nga pandemia COVID-19 dhe në kushtet e pamundësisë së realizimit të detyrave online në mënyrë

⁷ Njësoj vepron edhe nëse mësuesit nuk kanë mundur të kryejnë vetëm vlerësimin e portofolit.

të vazhdueshme, janë të mjaftueshme për të nxjerrë notën përfundimtare.

Shembull. Nëse një nxënës i klasës së tetë në lëndën e matematikës ka këto nota:

	NV _v	NT _p	NV _p
Periudha e parë (Shtator – Dhjetor)	8	7	9
Periudha e dytë (Janar – Mars)	9	NK	9
Periudha e tretë (Prill – Maj)	NK	NK	NK
Vlerësimet vjetore	9	7	9
Vlerësimi përfundimtar	$(NV_v \times 0.4) + (NT_p \times 0.4) + (NV_p \times 0.2) =$ $(9 \times 0.4) + (7 \times 0.4) + (9 \times 0.2) =$ $3.6 + 2.8 + 1.8 = 8.2 \approx 8$		

6.5 Vlerësimi i angazhimit të nxënësit gjatë gjithë procesit të mësimin në distancë

Mësuesi për të nxjerrë vlerësimin përfundimtar të nxënësve do të marrë në konsideratë arritjet e nxënësve që nga fillimi i vitit shkollor dhe do të fokusohet më së shumti në rezultatet e tyre përpara mbylljes së shkollës në 9 mars 2020. Gjithashtu, mësuesi do të marrë në konsideratë angazhimin dhe punën që ka bërë nxënësi gjatë periudhës së mësimin në distancë, por duke pasur *vetëm një ndikim pozitiv* mbi vlerësimin përfundimtar të nxënësit. Në rastet kur nxënësi:

- ka marrë pjesë rregullisht gjatë gjithë periudhës së zhvillimit të mësimin në kushtet e shtëpisë (sipas shënimeve që mësuesi ka mbajtur për frekuentimin e nxënësve),
- ka treguar gatishmëri dhe angazhim cilësor në kryerjen e detyrave të kërkuara nga mësuesi (sipas shënimeve që mësuesi ka mbajtur në fletoren personale),

atëherë pjesëmarrja dhe angazhimi do të merren në konsideratë nga mësuesi për vlerësimin përfundimtar të nxënësit.

Mësuesi (nëpërmjet mësuesit kujdestar) në rubrikën “Vlerësimi i kompetencave” në regjistër, shton edhe argumente për pjesëmarrjen e rregullt dhe për angazhimin cilësor të nxënësit gjatë mësimin në kushtet e shtëpisë, **si dhe ka të drejtë të shtojë një notë mbi notën përfundimtare të nxënësit.**

Pjesëmarrja e rregullt dhe angazhimi cilësor i nxënësit gjatë mësimin në kushtet e shtëpisë, mund të rrisë një notë mbi notën përfundimtare të nxënësit.

Shembull

Nëse në lëndën e matematikës nxënësi në klasën e tetë ka notën përfundimtare 8 dhe ndërkohë:

- ka marrë pjesë rregullisht në mësimin online të lëndës së matematikës sipas shënimeve të mësuesit në fletoren e tij për frekuentimin,
- ka qenë gjithmonë i rregullt në kryerjen në mënyrë cilësore të detyrave të dhëna nga mësuesi, në zgjidhjen e ushtrimeve apo situatave problemore,
- ka qenë i përpiktë në dorëzimin e detyrave të shtëpisë, detyrave krijuese apo hulumtuese në afatin e kërkuar,
- ka marrë pjesë aktive gjithmonë gjatë zhvillimit të mësimin online,

atëherë mësuesi (nëpërmjet mësuesit kujdestar) i shkruan të gjitha këto argumente në rubrikën “Vlerësimi i kompetencave” në regjistër dhe ka të drejtë që këtë nxënës ta vlerësojë **me notën përfundimtare 9.**

7. VLERËSIMI ME NOTË I NXËNËSVE QË NUK DO T'U NËNSHTROHEN PROVIMEVE KOMBËTARE TË ARSIMIT BAZË PËR VITIN SHKOLLOR 2019-2020

Për shkak të pandemisë COVID- 19, provimet kombëtare të arsimit bazë, për vitin shkollor 2019-2020, nuk do të zhvillohen. Vlerësimet e nxënësve me notë për këto provime do të bazohen në rezultatet e nxënësit gjatë të gjitha viteve të arsimit të mesëm të ulët.

Vlerësimet e nxënësve me notë për provimet kombëtare të arsimit bazë do të bazohen në rezultatet e nxënësit gjatë të gjitha viteve të arsimit të mesëm të ulët.

7.1 Procedura e llogaritjes së notës së provimeve kombëtare të arsimit bazë

7.1.1 Çdo shkollë do të ngrejë Komisionet për Vlerësimet e lëndëve të provimeve kombëtare të arsimit bazë (më poshtë Komisionet e Vlerësimit), me urdhër të drejtorit të shkollës.

7.1.2 Komisionet e Vlerësimit do të jenë për çdo lëndë që është provim kombëtar në arsimin bazë dhe kanë në përbërje 3 (tre) anëtarë:

- a) drejtori i shkollës;
- b) nëndrejtori që mbulon lëndën përkatëse;
- c) mësuesi i lëndës në klasën e nëntë.

7.1.3 Nëse shkolla nuk ka nëndrejtor, atëherë mund të jetë një mësues tjetër i së njëjtës lëndë ose një mësues i një lënde të përafërt me lëndën që është provim kombëtar.

7.1.4 Për të kryer procedurat e vlerësimit të nxënësve me notë në provimet kombëtare të arsimit bazë, Komisioni i Vlerësimit për lëndën përkatëse do të nxjerrë në një evidencë, notat e përfundimtare si më poshtë:

- | | |
|---|--|
| a) Nota përfundimtare e klasës VI. | b) Nota përfundimtare e klasës VII. |
| c) Nota përfundimtare e klasës VIII. | d) Nota përfundimtare e klasës IX. |

7.1.5 Nota e lëndës përkatëse të provimit kombëtar të arsimit bazë do të llogaritet si mesatare aritmetike e notave të vlerësimeve të pikës 7.1.4 me formulën:

NPK = [NP klasa 6 + NP klasa 7 + NP klasa 8 + NP klasa 9] : 4, ku NPK është nota e provimit kombëtar në lëndën përkatëse, NP është nota përfundimtare e lëndës për klasën përkatëse.

7.1.6 Procedura e parashikuar në pikën 7.1.5 zbatohet edhe për vlerësimin e nxënësve të pakicave kombëtare në lëndën “Gjuhë amtare”, të nxënësve të seksioneve dygjuhëshe, të nxënësve të shkollave speciale si dhe të nxënësve mbetës në provimet kombëtare të arsimit bazë

7.1.7 Komisioni i Vlerësimit mban procesverbal për rezultatet e nxënësve për lëndën përkatëse të arsimit bazë, të cilat dërgohen në Zyrën Vendore e Arsimit Parauniversitar (ZVA).

7.1.8 ZVA monitoron KV-të dhe raporton në DRAP për procedurat e vlerësimit me notë të nxënësve.

7.1.9 ZVA ruan dhe dërgon në QSHA, DRAP dhe DPAP rezultatet e nxënësve.

8. SHTOJCA 1 (PËR TESTET/DETYRAT PËRMBLEDHËSE)

8.1 Arsimi fillor (klasat 1-5)

Për vlerësimin me test përmbledhës në arsimin fillor mund të përdoren modele ushtrimesh të hartuara nga mësuesit, për nxënësit që punojnë në kushtet e shtëpisë. Lidhur me formën e organizimit të testit përmbledhës apo detyrës përmbledhëse, mësuesit mund t'u referohen lëndëve të paraqitura në pikat 2-7.

Shembuj pyetjesh.

• Pyetje me alternativa

1. Cili grupim është i rregullt sipas kohës?

- mësova, thashë, piva, këndoja.
- lexoi, hëngri, ndenji, takoi.
- do të hajë, do të thotë, pyeti, tha
- mësoj, punoi, luaj, këndoi.

2. Mendova një numër dhe i shtova 8. Përgjigjja është 14. Sa është numri?

- 4
- 6
- 8
- 10

• Pyetje me përgjigje: E vërtetë/ E rreme; Po/Jo; E saktë/E gabuar.

	E vërtetë	E rreme
1. Në ekuacionin $x \cdot 18 + 28 = 100$, vlera e x është 4.		
2. Sipërfaqja e përgjithshme e kubit është 150 m^2 . Brinja e tij është 10 cm.		
3. Me një tel të gjatë 32 cm formojmë një drejkëndësh. Gjerësia e drejkëndëshit është 6 cm. Gjatësia e tij është 10 cm.		

• Pyetje me kombinime (me çiftim).

Për të përcaktuar gjininë e emrit bazohemi te mbaresa që merr ai në:	përemër në rasën kallëzore.
Fjala “fluturova” është në kohën:	rasën emërore, njëjës, trajta e shquar.
Kundrinori i drejtë shprehet me:	e kryer e thjeshtë.

• Pyetje me plotësimin e vendeve bosh me informacionin e duhur nga një përkufizim apo proces.

Plotëso: Fjalë të pandryshueshme janë _____ dhe _____.

• Pyetje me përgjigje të shkurtër ose me plotësim.

Jepni një rast kur fjala “dorë” është përdorur në kuptim të parë.

Jepni një rast kur fjala “dorë” është përdorur në kuptim të figurshëm.

• **Pyetje subjektive me përgjigje të kufizuar.**

Një katror me brinjë 8 cm dhe një drejtkëndësh kanë të njëjtin perimetër. Nëse gjatësia e drejtkëndëshit është 12 cm, sa cm është gjerësia e tij?

• **Pyetje që vlerësojnë vlefshmërinë e zgjidhjes së një situatë problemore.**

A është vlere e shprehjes $8 \cdot 7 - 40 + 60 : 6 - 8 : 2 = 22$?

8.2 Gjuhë shqipe

Model për lëndën “Gjuhë shqipe”, arsimi 9-vjeçar

Për vlerësimin me test përmblendhës në lëndën e gjuhës shqipe, mësuesit përcakton çështjet më të rëndësishme që do të vlerësohen në varësi të rezultateve të të nxënësve që ka planifikuar për periudhën e tretë. Kështu mësuesi harton një test me:

- një tekst (letrar ose joletrar). P.sh., për tekstin letrar nxënësit mund të vlerësohen për çështje të tilla: subjekti; analiza e personazheve; përshkrimi i kohës dhe i vendit; lidhja e tekstit me jetën e përditshme; tema, motivet, mesazhi dhe interpretimi i tyre; identifikimi dhe analiza e tipareve gjuhësore të tekstit etj.
- disa ushtrime që kanë lidhje me njohuritë dhe aftësitë e nxënësve rreth sistemit gjuhësor të shqipes.

Mësuesi përcakton edhe kriteret e vlerësimit sipas niveleve të arritjes dhe konvertimin në notë për të ruajtur parimin e transparencës dhe të objektivitetit në vlerësim. Ai ua komunikon nxënësve rezultatin dhe vlerësimin përkatës duke bërë komentet e nevojshme për arritjet e tyre.

8.3 Gjuha e huaj

Për vlerësimin e nxënësve në lëndën e gjuhës së huaj, mësuesi përzgjedh ushtrime të llojeve të ndryshme në mënyrë që t’u përshtatet moshës dhe nivelit të tyre.

Mësuesi duhet të ketë parasysh që në ushtrimet e përzgjedhura, të përdoret gjuhë e thjeshtë dhe jo e mbingarkuar me fjalë të vështira dhe koncepte gjuhësore të panjohura nga nxënësi. Gjithashtu mësuesi nuk duhet të fokusohet në konceptin gramatikor si qëllim në vetvete. Testimi i çdo koncepti gjuhësor duhet të jetë në një kontekst të njohur për nxënësin.

Për të realizuar vlerësimin me test ose detyrë përmblendhëse në lëndët e gjuhës së huaj, mësuesi harton ushtrime për:

Të kuptuarin e një pjese leximi

- Për nivelet B1 dhe B2, mësuesi përzgjedh një pjesë leximi dhe harton pyetje për idenë kryesore, detajet e ndryshme, kuptimin e fjalëve në kontekst etj.
- Për nivelet B1 dhe B2, mësuesi përzgjedh një pjesë leximi, letër, artikull, ku hiqen disa fjalë ose pjesë fjali dhe i kërkohet nxënësit të plotësojë vendet bosh me fjalët e hequra, të cilat jepen në rend të çrregullt.
- Për nivelin A1, mësuesi përzgjedh një pjesë shumë të thjeshtë leximi dhe në vend të disa fjalëve ka vendosur figurat. Nxënësi duhet të shkruajë fjalën që i përket secilës figurë.

Përdorimin e gjuhës

- Për nivelin A1 dhe A2, mësuesi përzgjedh një dialog të thjeshtë dhe vendos foljet në kllapa. Nxënësit duhet të vendosin foljet në kohën e duhur.
- Për nivelin B1 dhe B2, mësuesi përzgjedh një dialog me temë nga jeta shkollore dhe iu kërkon nxënësve ta kthejnë dialogun në një tregim, duke kthyer fjalitë në ligjëratën e zhdrejtë.

- Për nivelin B2, mësuesi përzgjedh një artikull të thjeshtë gazete ku heq disa fjalë (këto fjalë duhet të lidhen me strukturat gramatikore) dhe nxënësi gjen fjalën që mungon.

Të shkruarin

- Për nivelin A1 dhe A2, nxënësve mund t'u kërkohet të shkruajnë një përshkrim të thjeshtë si (Pushimet, Dita ime më e bukur, Mësuesi im i preferuar, etj.) ose një tregim me temë të nga jeta e përditshme.
- Për nivelin A2 dhe B1, nxënësit mund të shkruajnë një letër ose email jo formal. Për nivelin B1 dhe B2 nxënësit shkruajnë një letër ose email formal, letër kërkesë, letër aplikimi etj.
- Për nivelet B1 dhe B2, duke pasur parasysh nivelin e nxënësve, njohuritë e tyre në TIK, mësuesi harton një detyrë ku iu kërkon nxënësve të krijojnë një Blog të thjeshtë.
- Për nivelin B1 dhe B2, mësuesi iu jep nxënësve një temë eseje për të shkruar ose analizë të një romani që kanë lexuar ose filmi që kanë parë kohët e fundit.

Të folurin

- Filmohen ose regjistrohen 2-3 minuta ku nxënësit flasin për një temë të caktuar sipas nivelit.
- Organizohet online një debat i shkurtër dhe i thjeshtë mbi një temë të caktuar.

8.4 Matematikë

Për vlerësimin me test përmbledhës në lëndën e matematikës, mësuesi përzgjedh çështjet kryesore që do të kontrollohen. P.sh., për derivatin, integralin, eksponencialin dhe logaritmin (klasa 12). Mësuesi liston konceptet kryesore për këto çështje në varësi të përmbushjes së rezultateve të të nxënit të kompetencave matematikore dhe ua prezanton nxënësve duke dhënë sqarimet përkatëse, si më poshtë:

- Përkufizime dhe veti të vektorëve.
- Koordinatat e vektorit.
- Kampionimi.
- Karakteristikat e pozicionit dhe të shpërndarjes.
- Të dhënat me një ndryshore.
- Të dhënat me dy ndryshore.
- Probabiliteti.
- Shpërndarja e probabiliteteve.

Lidhur me këto çështje, mësuesi mund të hartojë një fond ushtrimesh, situatash problemore nga jeta reale (p.sh., 2-3 ushtrime për secilin koncept), i pikëzon secilin prej tyre, i udhëzon nxënësit dhe ua jep atyre për t'i zgjidhur duke u lënë një afat të përcaktuar. Mësuesi i diskuton me nxënësit për të parë saktësinë e zgjidhjeve të tyre.

Mësuesi përcakton edhe kriteret e vlerësimit sipas niveleve të arritjes dhe konvertimin në notë për të ruajtur parimin e transparencës dhe objektivitetit në vlerësim.

Më pas, mësuesi zhvillon testin përmbledhës, një test i thjeshtë dhe i shkurtër. Mësuesi u komunikon nxënësve rezultatin dhe vlerësimin përkatës duke bërë komentet e nevojshme për arritjet e tyre.

8.5 Shkencat e natyrës

Për vlerësimin me test ose detyrë përmbledhëse në lëndët e shkencave të natyrës

Në lëndët e fushës "Shkencat e natyrës" mësuesi përzgjedh çështjet më të rëndësishme që do

të vlerësohen në varësi të rezultateve të të nxënësve që ka planifikuar për periudhën e tretë. P.sh., nëse do t'i referoheshim programit të biologjisë me zgjedhje në klasën e 12-të mësuesi përgatit një listë me çështjet/konceptet kryesore të periudhës si më poshtë:

Ndryshimet e trashëgueshme

- Mejoza
- Gametogjeneza
- Trashëgimia Mendeliane
- Alelet e shumëfishta, Kodominanca
- Trashëgimia e lidhur me seksin
- Gjenet e lidhura dhe kryqëmbimi

Përzgjedhja dhe evolucioni

- Gjenetika e popullatave
- Ligji Hardy-Weinberg
- Variacioni

Diversiteti biologjik- ekosistemet

- Ekosistemet
- Diversiteti biologjik (larmia biologjike)
- Ndryshimet në madhësinë e popullatave

Mësuesi iu prezanton nxënësve listën me konceptet kryesore duke iu bërë dhe sqarimet përkatëse për të bërë përsëritjen. Paraprakisht mësuesi përgatit edhe një fond me pyetje, ushtrime dhe problema, të cilat i zhvillon me nxënësit. Testi përmbledhës do të hartohet mbi bazën e këtij fondi pyetjesh. Nxënësit përgatiten sipas udhëzimeve për të kryer testin përmbledhës të periudhës. Mësuesi vlerëson testet dhe ia komunikon secilit nxënës individualisht bazuar në kriteret e vlerësimit.

8.6 Histori

Për vlerësimin me detyrë përmbledhëse në lëndën e historisë, mësuesi mund të përdorë një veprimtari praktike. Për këtë, mësuesi iu paraqet nxënësve si temë një veprimtari të përcaktuar në program dhe të zhvilluar në tekst për periudhën e tretë. Përmes saj, mësuesi vlerëson atë grup të rezultateve të të nxënësve, të cilat ai i ka veçuar si më të rëndësishme për t'u përmbushur gjatë mësimin në kushtet e shtëpisë për periudhën e tretë. Për zhvillimin e veprimtarisë praktike mësuesi tregon kujdes të përcaktojë konkretisht se çfarë detyre do të zhvillojë secili nxënës ose grup nxënësish, si dhe burimin me të cilin do të punojë nxënësi për realizimin e saj.

Për realizimin e detyrës, mësuesi:

- Udhëzon nxënësit që secili prej tyre t'u përgjigjet një sërë pyetjesh të përgatitura paraprakisht nga ai, si p.sh.: Çfarë burimi keni përdorur?; Cilat janë konceptet historike kyç që keni gjetur në këtë burim?; Në çfarë periudhe kohore shtrihet ngjarja?; Rendit informacionin historik për vendet dhe periudhat e përfshira në burimin e dhënë duke përfshirë të dhënat dhe konceptet më të rëndësishme.; Cilat janë shkaqet që ndodhi...?; Cilat qenë pasojat...?; *Në këtë mënyrë, mësuesi vlerëson jo vetëm për njohuritë e fituara, por dhe për kompetencat dhe konceptet historike kyç, si: kërkimi, përdorimi i burimeve, kronologjia, ndryshimi dhe vazhdimësia, interpretimi historik, analiza shkak-pasojë.*

- Harton paraprakisht kriteret e vlerësimit të detyrës dhe ua komunikon nxënësve.
- Përcakton kohën e nevojshme për kryerjen e detyrës dhe ua komunikon nxënësve.
- Udhëzon nxënësit të punojnë në mënyrë individuale apo në grup sipas çështjeve apo detyrave të përcaktuara nga ai.
- Vlerëson detyrën mbi bazën e kriterëve të përcaktuara dhe në ditët në vazhdim, ia komunikon nxënësit rezultatin, duke bërë komentet e nevojshme.

8.7 Gjeografi

Për vlerësimin me detyrë përmblledhëse në lëndën e gjeografisë, si pjesë e fushës “Shoqëria dhe mjedisi”, mund të përdoret detyrë e tipit ese, veprimtari praktike etj. Përmes saj, mësuesi vlerëson grupin e rezultateve të të nxënësve të periudhës që ka veçuar si më të rëndësishme, në varësi të rezultateve të të nxënësve që ka planifikuar të përmbushë për atë periudhë.

Shembull:

Detyrë përmblledhëse, klasa e 9-të.

Pasi nxënësit kanë zhvilluar gjatë periudhës njohuritë dhe aftësitë për trashëgiminë natyrore dhe kulturore të rajoneve të Republikës së Shqipërisë, mësuesi jep një detyrë përmblledhëse të tipit ese argumentuese me temë: *“Trashëgimia natyrore dhe kulturore e rajonit.....- potencial për zhvillimin e rajonit”*.

Për realizimin e detyrës:

- Mësuesi udhëzon nxënësit që secili prej tyre është i lirë të përzgjedhë njërin prej rajoneve të Republikës së Shqipërisë, të cilin do ta marrë në shqyrtim. Mbi bazën e njohurive dhe aftësive që nxënësi ka zhvilluar në lidhje me trashëgiminë natyrore dhe kulturore të rajonit të përzgjedhur prej tij, ai duhet të gjykojë mbi mundësitë për zhvillim të këtij rajoni.
- Mësuesi harton paraprakisht kriteret e vlerësimit të detyrës sipas niveleve të arritjeve dhe konvertimin në notë dhe ua komunikon nxënësve.
- Mësuesi përcakton kohën e nevojshme për kryerjen e detyrës dhe ua komunikon nxënësve.
- Nxënësit punojnë në mënyrë individuale për të shprehur dhe argumentuar mendimin e tyre dhe dorëzojnë esenë e përgatitur te mësuesi.
- Mësuesi, mbi bazën e kriterëve të përcaktuara, vlerëson detyrën dhe, në ditët në vazhdim, ia komunikon nxënësit rezultatin, duke bërë komentet e nevojshme.